




Drita e Kur'anit



FLETUSHKË E SHOQATËS SË NXËNËSVE TË MEDRESESE SË MESME "ALAUDDIN" NË PRISHTINË



Fjala e kryeredaktorit

Koha në të cilën po jetojmë është kohë në të cilën njerëzimin e kanë kapluar sëmundje të ndryshme që çojnë në dexiorentim dhe degjenerim. Njerëzit janë sulmuar nga epshet, ku së tepërmi e tërheqin gjërat e këndshme. Shumë të rinj dhe të reja janë bërë si automat që i imitojnë të tjerët në mënyrë të verbër. Kanë filluar të ndjekin moda të ndryshme, me shpenxime dhe shfrenim. Madje që është më fatale, kanë filluar të ndjekin edhe modën lakurige. Për fat të keq të këta, e keqja është bërë e mirë, e pa vlera, vlerë dhe anasjelltas. E gjithë kjo është si pasojë e imitimit të verbër, i cili është ndër faktorët më të mëdhenj për degradimin e personalitetit, prishjen e moralit, humbjen e burrërisë e nderit... Prandaj është më se e nevojshme që dikush ta udhëzojë këtë shoqëri, ta ofrojë në limanin e shpëtimit. Ndërsa rinia është shpresa e kësaj shoqërie, shpresa e rilindjes dhe qëndresës... që duhet të jetë shembull në moral në ibadet, qëndrueshmëri, ahihad...

Edhe ne si të rinj me kontributin dhe përpjekjet tona modeste u munduam dhe do të mundohemi që rrezet e Dritës së Kur'anit" t'i reflektojmë edhe tek ju.

Dëshirojmë që "Drita e Kur'anit" edhe më tutje të jetë ajo që ishte - kandil ndriçues që t'ju ndriçojë rrugën e fatbardhësisë dhe të mirës.

Çdo gjë qarkullon në një rreth të pandërprerë. Pas jetës vjen vdekja, pas ëndrrës xgjimi. Dhe kështu nga dita në ditë, vjen deri tek disa ndryshime...

Lexues të nderuar, do të mundohemi, me ndihmën e All-llahut sh.sh. që "Drita e Kur'anit" edhe më tutje të jetë ajo që ka genë - fletushkë e nxënësve, e njëherit të pasurohet për nga cilësia e përmbajtja.

Dë të kemi punë e frytë të mbara, na nevojitet edhe ndihma juaj. Na shkruani çka ju pëlqen, çka mungon, çka ju intereson më së shumti, çka është e tepërt etj. Sugjerimet e juaja janë shumë të dobishme që fletushkën tonë dhe tuajën ta bëjmë sa më të mirë.

Kryeredaktori:

Botues: Shoqata e nxënësve të Medresesë së Mesme "Alauddin" Prishtinë

Kryeredaktor: **Irfan Krasniqi**

Këshilli redaktues: Bajrush Ahmeti, Rustem Spahi, Jusuf Gashi, Ahmet Rama, Muhamet Broja, Afrim Jusufi, Shkelzen Salihu, Adem Breznica, Driton Morina dhe Alban Tahiri

Lektor dhe Korrektor: Jusuf Gashi

Përpunimi kompjuterik: 

Fletushka del sipas mundësisë

Adresa: Redaksia e "Nurit", f.p. 89. Prishtinë

Tel. 038/32-472 & 32-473

është lejuar botimi i fletushkës "NUR-UL-KUR"AN" me vendimin e Sekretariatit për informata të Kuvendit të Kosovës dhe Këshillit Ekzekutiv nr.01-650-64 të td.18.03.1973 në Prishtinë

Dorëshkrimet dhe fotot, nuk kthehen

Përmbajtja

Rreze e ndriçimit islam "moralit"	3
Obligimet ndaj Allahut sh.sh.	4
Kurbani - afrim ndaj mëshirës hyjnore	6
Besimi i singertë në Allahun është ilaqi më i mirë për sëmundjet e kohës sonë	8
Dijetarët joislamë dhe argumentimet e tyre mbi qenien e Zotit në baza shkencore - kosmologjike	10
Imamul A'dham - Ebu Hanife	12
Isai a.s., zot apo i dërguar i Zotit?	15
Petku i çuditshëm, ku!?	18
"Zemrën e kam të pastër"	19
Origjina dhe filltet e gjinisë njerëzore	20
Dituria, fryt i agnazhimit	21
Belaja e gjuhës.	22
Kënaqësia në muajin e bekuar	23
Malishevë - Shkoroshnik	24

Rreze e ndriçimit islam "moralit"

Ata që nuk i përgjigjen thirrjes së Zotit, mendojnë se secilës punë ia dinë rendin e futen rreziqeve të ndryshme por kuptohet të tillët i pret dënimi. Në lidhje me këtë në Kur'an thuhet:

"(Dispozitë obliguese) është që laviren dhe lavirin t'i rrihni, secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të Allahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse i besoni Allahut dhe botës tjetër, e gjatë zbatimit të ndëshkimit të tyre le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh".

Kaptina Nur: 2.

Kështu pra kërkohet të dënohen laviri dhe lavirja, dënim që duhet të ekzekutohet para publikut dhe pa treguar zemërbutësi ndaj tyre.

Meqë i dërguari i Zotit, Muhamedi a.s. ata që bënin prostitucion i dënonte me një dënim që ekzekutohej gjithashtu para publikut, por në ekzekutim merrnin pjesë edhe vetë publiku me goditje me gurë deri në vdekje, e dënimi i lartëpërmendur në citatin Kur'anor vlen vetëm për të pamartuarit. Ky është mësim për të tjerët.

"Kështu është ligji i Zotit, kurse ligjet që njeriu i shpik për njeriun, kuptohet se janë të ndryshme, të çuditshme, afatshkurte, jostabile, e as që vlejnë për të gjithë.

Është për t'u çuditur kur dimë faktin se disa shtete filluan të japin kurajo e të thërrasin në lirinë njerëzore. Ata lirinë njerëzore e panë në bashkimin e gjinive, në prostitucion. Përkundrazi, ata hynë në një labirinth nga i cili vështirë është të dilet. Si rezultat i daljes nga ky labirinth dhe i kësaj lirie, siç e quanin ata, ishte sëmundja e rëndë "Sida" - sëmundje vdekjepruese, kundër të cilës deri tani nuk u gjet shërimi. Ata që thirrën në këtë liri dhe e quanin liri të plotë, tashmë ngritën zërin e tyre të largojnë nga kjo liri.

- Natyrën e njeriut më së miri e di Ai që e krijoi, ligjet e tij janë të përsosura, e me ligjet tjera, lirisht, mund të themi se bëhen eksperimente me njerëz. Ja, pra, ata që nuk dënohen me atë të parën, dënohen me pasojat që i godasin njëra pas tjetrës. Me lart u përmend "Sida", thënë të vërtetën ekzistojnë shumë sëmundje

tjera të mëdha të cilat paraqesin problem të madh për mjekim. Dr. Xhon betson thotë: *"Sëmundjet më të mëdha trupore janë rezultat i lidhjeve jashtëbashkëshortore".*

Por këtu nuk bëhet fjalë vetëm për sëmundje të kësaj natyre, këtu paraqiten edhe sëmundje shpirtërore me pasojat tragjike si: humbja e karakterit, mosrespektimi i normave të moralit, lindin atë që është djallëzore si: ngatërresa, rrahje, vrasje, shkurorëzime...

Duhet theksuar edhe atë se orvatjet e atyre që thirren të dalin nga labirinthi filluan herët, por pa rezultat.

Detyra e jonë është të përhapim njohuritë mbi gjërat shkatërruese, rastet shoqërore dhe konceptet etike dhe sëmundjet gjinore, mjekimin gjinor dhe të përmbajturit e detyruar. Këtu po zhvillohet rrëmujë e imoralitetit, andaj për pengimin e kësaj duhet të merren masa sanitare por edhe shpirtërore.

Ç'është e vërteta, rezultatet janë gjithnjë e më larg, kështu ngase pikësëpari nuk luftohen shkaqet e saja. Madje edhe aspak nuk gabojmë nëse themi se orvatjet as që ekzistojnë pos në letër. Ne anën tjetër thirret papushuar përmes revistave, televizionit... E thirrjen e mbron ligji.

- Sa mrekullisht Balzaku përfundon romanin "Pjereta".

"Do të pranojmë se ligji do të mbronte të gjitha poshtërsitë shoqërore po të mos kishte drejtësi hyjnore".

Moshatarë të mi, duhet ditur se ata të cilët mendojnë se janë të lirë nga dënimi çka do që veprojnë, le të mos gëzohen, vetës veç ia kanë siguruar dënimin e rreptë.

Pra, për ne dhe për të gjithë, prostitucioni është rruga e errësirës dhe e tmerrit, andaj të ecim me plotë gjallëri rrugës së ndriçuar me dritë të vërtetë, rrugës së shpresës që të jemi me shpresë, rrugës së fitores që të jemi fitues.

Moshatarë të mi, paqja dhe mëshira e të Madhit Zot qoftë me ne!

Arsim Sopu IVa

OBLIGIMET NDAJ ALLAHUT XH.SH.

Vetë forma apo modeli i jetës në fenë islame është një varg të drejtash e obligimesh, të cilave çdo qenie njerëzore duhet t'i adaptohet. Ndër ato obligime është edhe vetë obligimi ndaj Allahut xh.sh., të cilin çdonjeri i mençur, që di të logjikojë duhet, pa tjetër, ta kryejë. Një ndër obligimet e para të njeriut ndaj Zotit të vet është të besojë Atë se nuk ka zot tjetër përveç Tij. Kjo është përmbledhur në kelimet she-hadet:

LA ILAHE IL LLALL LLAH (NUK KA ZOT TJETËR POS ALLAHUT).

Obligimi ynë i dytë ndaj Zotit është t'i pranojmë singërisht udhëzimet e Tij, me gjithë zemër e me shpirt. Në Kur'an thuhet:

"Falënderomni Mua e mos u bëni të pafalënderueshëm. Përkujtomni MUa e Unë do t'ju përku-jtoj me të mirat e Mia".

Nënshtrimi ndaj Allahut është një ndër obligimet tona. Myslimani, që të jetë mysliman, duhet t'i përmbahet ligjit të Zotit d.m.th. t'iu përmbahet fjalëve të Zotit xh.sh. që janë të cekura në Kur'an dhe traditës apo udhëzimeve të pejgamberit a.s., Sun-netit. Edhe adhurimi është ndër obligimet e myslimanit, dhe kryerja e obligimeve të cilat i parasheh adhurimi.

Këto ishin disa nga obligimet ndaj Allahut, të cilat kanë përparësi ndaj obligimeve të përditshme, si: namazi, agjërimi, zekati, haxhi, xhihadi etj.

NAMAZI është lidhja më e ngushtë ndërmjet krijesës me Krijuesin e vet. Namazi është lutje e obliguar e secilit besimtar, e cila kryhet pesë herë në ditë, dhe janë lidhjet direkte me Allahun xh.sh.. Kjo lidhje duhet, patjetër, të jetë e përditshme, sepse këtë na e përshkruan edhe Kur'ani ku thotë:

"Me të vërtetë namazi është obligimi (për kohë) i caktuar për besimtarët".

Namazi është e vetmja normë në islam e cila parashihet në të gjitha rrethanat dhe situatat të cilat e godasin myslimanin. Gjithashtu, namazi është

arma më e fortë si në paqë ashtu edhe në luftë. Nuk ka dyshim se roli kryesor i namazit është që të formojë personalitete të shëndosha dhe të fuqishme. Personalitete të cilat do ta kuptonin esencën e jetës njerëzore, të cilat nuk do të bien, asnjëherë, në kapitulum para vështirësive dhe problemeve jetësore. Më parë përmendëm se namazi është ajo lidhja ndërmjet krijesës me Krijuesin e vet. Me hyrjen në namaz, me tekbir (Allahu Ekber), njeriu dëshmon dhe beson se nuk ka ndonjë problem të cilin, ai me vullnetin dhe dëshirën e Allahut, nuk do ta zgjidhë. Me namaz arrihet qetësia dhe siguria shpirtërore, e kjo prapë është pushim më i mirë për trupin dhe sistemin nervor. Një dijetar i quajtur me emrin Tomas Hajsulb, duke folur për namazin, thotë: *"Ka bindje të thellë në praktikën e tij shumëvjeçare, se qetësia dhe rehatia nuk arrihet me asgjë tjetër si me namaz. Asgjë sikurse namazi nuk mund t'i qetësojë nervat e tij".*

Pra, namazi është lidhja më e ngushtë ndërmjet njeriut dhe Zotit, gjithashtu edhe marrëdhëniet ndërnjerëzore me të cilat lidhet miqësia dhe dashuria e njerëzve në mes tyre.

Agjërimi është një formë e të adhuruarit të Allahut xh.sh.. Për çdo vit, gjatë muajit të Ramazanit, të gjithë muslimanët agjërojnë prej mëngjesit e deri në muzg (terr), duke u përmbajtur nga ushqimet, pijet dhe marrëdhëniet intime. Atyre të cilët janë të sëmurë, të vjetër, ose gjenden në rrugë, të cilët janë në shërim, u është lejuar të ndërprejnë agjërimin dhe numrin e saktë të ditëve të lëshuar t'i kompenzojë më vonë gjatë vitit.


Nëse atë fizikisht nuk mund ta përballojnë (mbajnë), duhet të ushqejnë të varfërin për secilin ditë të lëshuar. Edhe pse agjërimi është më i dobishëm për shëndet, ai kryesisht merret (veshtrohet) si metodë e vetëpastrimit. Duke ia ndalur vetës jetën komode, bile edhe vetë për pak ai, i cili agjëron singërisht ballafaqohet me ata, të cilët kanë uri. Agjërimi, me një fjalë, të forcon në kuptimin shpirtëror.

Zekati: Një ndër parimet më kryesore në islam është se: çdo gjë që ekziston, i takon Zotit xh.sh. dhe se pasuria i është dhënë qenieve njerëzore. Fjala "ZEKAT" d.m.th. "PASTRIM" dhe "RRITJE". Secili musliman e llogarit vetë zekatin për vete. Për shkak të efektit, ai llogarit ndarjen e dy apo më shumë përqind të pasurisë së tij çdo vit dhe këtë e shëprndan për të varfërit. Personat fetare, gjithashtu, mund të japin sa të duan si sadaka e sipas mundësisë fshehtë. Megjithatë kjo fjali mund të përkthehet si "kontribut vullnetar", ajo ka kuptim dhe d.m.th. më të gjerë. Muhamedi a.s. ka thënë: "Edhe takimi me të vëllain duke buzëqeshur është sadaka". Pastaj në një hadith tjetër thuhet: Se: "Mëshira është obligim i secilit musliman". E kanë pyetur Muhamedin a.s.: E çka, nëse dikush nuk ka asgjë? Pejgamberi a.s. është përgjigjur: "Atëherë duhet ai me duart e veta personale të fitojë diçka dhe të ndajë nga ajo për mëshirë. "Të besueshmit e tij e pyetën: Çka nëse ai nuk mund të punojë? Pejgamberi a.s. përgjigjet: Duhet të ndihmojë të tjerët që të bëjnë mirë". Besimtarët thanë: "Çka nëse as atë nuk e bën? Pejgamberi a.s. (atëherë) përgjigjet: "Atëherë duhet vetëm ndalur vetëveten nga të bërit keq. Edhe kjo është mëshirë".

Haxhillëku: Hagjillëku vjetor në Mekë është obligim vetëm për ata që janë fizikisht dhe materialisht të aftë të kryejnë atë. Ai është një obligim që bëhet vetëm një herë gjatë tërë jetës, përveç sipas dëshirës së tij.

Në Haxh haxhinjtë bartin rroba të posaçme. Rrobet e thjeshta të cilat i neutralizojnë dallimet ndërmjet klasave dhe kulturave të të gjithë njerëzve nga gjithë bota. Kështu që para Zotit të gjithë duken njësoj pa dallim kombi a race.

Ceremoninë e haxhit, e cila daton nga Ibrahim a.s., fillon duke u sjellë rreth Qabes shtatë herë (tavaf), pastaj vrapimi mes kodrave Safa dhe Merva, si ka vepruar Haxherja duke kërkuar ujë (për të birin Ismailin a.s.). Pastaj haxhinjtë qëndrojnë së bashku në rrafshirën e gjerë të Arafatit dhe i bashkangjiten lutjes për falje nga Zoti fuqiptotë, e cila shpesh konsiderohet si vështrim (shikim) i fundit në ditën e gjykimit (gjykimi i fundit).



Xhihadi: Edhe ky është një ndër obligimet kryesore të muslimanit sepse muslimani i vërtetë për t'u afruar tek kënaqësia e Allahut xh.sh. bën çmos, si: jep pasurinë e tij qoftë të holla apo pasuri tjetër, por në çoftë se nevojitet ai flijon edhe vetën vetëm për sëndërtimin e idealeve të fesë dhe për të arritur mëshirën dhe kënaqësinë e Allahut xh.sh. Në Kur'an thuhet:

"Dhe luftoni në rrugën e Allahut kundër atyre që ju sulmojnë e mos e teproni se Allahu nuk i do ata të cilët e teprojnë".

Dhe ajete të tjera, ku Allahu xh.sh. thotë:

"Dhe luftoni ata kudo që t'i zini, dëboni prej vendit ata sikurse ju përzunë ata juve. Provokimi (fitneja) është më e rëndë se vrasja. Mos i luftoni ata pranë xhamisë së shenjtë (Qabes) deri sa ata t'ju luftojnë juve aty, e nëse ju sulmojnë, sulmoni edhe ju ata. I këtitillë është ndëshkimi për pabesimtarët. E nëse heqin dorë (edhe ju hiqni dorë) Allahu është Ai i cili fal dhe mëshiron".

Pra këto ishin disa nga obligimet më kryesore të cilat duhet t'i praktikojë çdo musliman në jetën e përditshme familjare.

Ardian Haliti IVb

KURBANI - AFRIM NDAJ MËSHIRËS HYJNORE

Falënderimet, përuljet dhe adhurimet janë për Allahun, Zot i botave. Përsëritet, bekimet dhe selamet tona qofshin për pejgamberin a.s. familjen, shokët e tij dhe të gjithë ata që i përmbahen udhëzimit të tij.

Besimi, humanizmi, sakrifica e bindja e thellë te njeriu përfaqësojnë elementet më thelbësore, dritën më shkëlqimplotë dhe fuqinë më të madhe, që mund të përballojë dhe të mposhtë çdo forcë. Është e pamundur që një shpirt pa këto të ngrihet në lartësinë e përsosmërisë njerëzore, qoftë sikur të jetojë edhe me qindra vjet. Për këtë, çdo musliman me ndërgjegje të lartë e të pastër, i bindur në fenë islame dhe fuqinë e saj që ta pajisë me këto virtyte mundohet sa më shumë që t'i jetësojë dhe t'i sëndërtojë në personalitetin e tij këto virtyte. Pa dyshim se ai përfitimin-arritjen deri te këto e bën me anë të rrugës të cilën ia trasoi Krijuesi i tij që është i Gjithdijshtëm dhe i Gjithpushtetshëm. Me një qëndrim të tillë meritohet ndaj Krijuesit të vet, muslimani hapëron drejt shkallëve të devotshmërisë dhe përsosmërisë së tij dhe ideali i tij mëton të jetë afrimi sa më i shpejtë pranë mëshirës së pakufishme të Krijuesit të vet - Allahut xh.sh.

Mirëpo, i gjithmëshirshmi bëri që ky afrim të kultivohet në shumë mënyra, e njëjën ndër ato muslimanët e realizojnë me rastin e festës së Kurban Bajramit.

Ata, në këto ditë, përkujtojnë mundin, angazhimin, vuajtjet në njëjën anë dhe qëndresën, krenarinë ballëlartësinë në anën tjetër të të parëve të tyre të cilët në durimin dhe qëndresën e tyre gjithherë i kishin shoqëruar besimi i çeliktë, flijimi dhe humanizmi.

Ata nuk ndalen së përkujtuari edhe atë mësimin fisnik të cilin ia shpalli Allahu xh.sh. Muhammedit a.s. në këtë ajet Kur'anor:

"Thuaj (Muhammed): Namazi im, kurbanimi im, jeta ime, dhe vdekja ime janë vetëm për Allahun, Zotin e botave".

Ata, si gjithherë, edhe në këto ditë e dinë se t'i respektosh urdhërat e Allahut, do të thotë t'i zbatosh ato edhe në vepër dhe t'i ndjesh shpirtërisht e të jetosh me to. Mu për këtë muslimanët para kësaj feste i sheh duke nxituar nëpër tregje, që secili prej tyre të blejë një kurban dhe në ditët festive me prerjen e tij të zbatojnë domethënien e fjalës Kurban, e cila është: Afrim tek Allahu xh.sh. dhe gatishmëria për çdo sakrificë në emër të Tij. E pas kryerjes së këtij akti i sheh fytyrat e tyre të gëzuara, të hapura dhe në to gjithashtu sheh njerëz me shpirtëra të qetë bujarë, fisnikë flijues, ngase kurbanit atyre u ka mundur t'i flakin vetitë negative, t'i shërojnë sëmundjet shpirtërore për atë se ata me këtë iu përkushtuan me tërë qenien e tyre Allahut xh.sh..

Ata pas kësaj assesi nuk iu ngjajnë atyre që ndajnë shuma të mëdha nga pasuria e tyre, ndajnë gjëra të çmueshme vetëm e vetëm për të arritur një pozitë në këtë jetë të shkurtër, kurse të gjojnë harrojnë Krijuesin e tyre, harrojnë të mirat e panumëruara prej tij.

Për ata flijimi, sakrifica është një armë me anë të së cilës mund të kapërcehen çdo pengesë dhe një çelës që hap çdo derë.

Njëkohësisht ata janë të vetëdijshtëm se qëllimi final i çdo obligimi islam, pra edhe i kurbanit, është që njeriu të përsoset moralisht, të pajiset me ndjenja fisnike, të ndjejë dashurinë ndaj të vërtetës, ndaj drejtësisë dhe ndaj çdo gjëje që është e mirë dhe njerëzore. prandaj edhe i sheh ata se si veprojnë punë të mbara dhe largojnë të keqen, kudo qoftë dhe kurdo qoftë.

Element tjetër është edhe ai se ata mishin e kurbanit ua shpërndajnë të varfërve, të afërmeve, fqinjve dhe vetëm një pjesë prej atij mishi e ndajnë për vete, pra në punën e tyre fusin edhe virtytin e humanizmit, mirëbërjes si dhe dëshmojnë dashurinë dhe kujdesin e tyre ndaj anëtarëve tjerë të shoqërisë. Dëshmojnë se janë të gatshëm t'u dalin në ndihmë në çdo rast, sepse janë të bindur se Allahu do të jetë në anën e tyre dhe do t'i ndihmojë. Të tillëve as vdekja nuk ua shuan

gjurmët, sepse nuk thuhet kot se ai njeri që jeton dhe e sakrifikon vetveten për humanizmin është një monument pavdeksie.

Prej këtu shohim se Allahu xh.sh. nuk qenka i interesuar për mishin dhe gjakun e kurbanëve tanë, për atë se, është fakti i pamohueshëm, se Ai nuk ka nevojë për asgjë dhe për askë. Atij nuk i shtohet asgjë e as nuk i mungohet asgjë nga pushteti i Tij Hyjnor premë apo nuk premë kurban për Të, por Atij i intereson gjurma e cila mbetet te ne me kryerjen e këtij akti, i intereson devotshmëria e zemrave tona. Allahu xh.sh. thotë:

"Tek Allahun nuk arrin as mishi e as gjaku i tyre (kurbanor) por tek Ai arrin bindja dhe devotshmëria e juaj...".

Pra, sipas këtij ajeti Kur'anor, qëllimi i kurbanit qenka mbjellja e dashurisë dhe respektit ndaj Allahut xh.sh. e që me anë të kësaj të arrihet deri te çrrënjësia e ndjenjës së smirës, urrejtjes, padrejtësisë dhe koprracisë.

Pra, ky institucion na ndihmon të arrijmë bashkim zemrash e mendimesh, duke mbizotëruar interesat individuale dhe mbi to të vendosim interesat shoqërore, sepse ky solidaritet njerëzor e vëllazëror i afron të gjithë vëllezërit muslimanë, i shndërron ata në një trup të vetëm, në një fuqi të pathyeshme dhe në këtë mënyrë ata me plot të drejtë mbajnë flamurin e ymetit më të mirë nga të gjitha ymetet e mëhershme.

Pas gjithë kësaj që thamë para nesh paraqitet një pamje modeste mbi urtësinë e këtij obligimi, mirëpo dhe njëherë duam ta tërheqim vërejtjen në fjalën e Allahut xh.sh.: "Allahu pranon (kurbanin) vetëm prej të singertëve".

O Zot, të lutem që të na dhurosh të mira të llojllojshme dhe të falënderohemi për begatitë që na i ke dhuruar, na mundëso të bëjmë vepra të mira dhe të hyjmë në xhennet me mëshirën Tënde e të jetojmë me robërit e devotshëm.

Amin

DRITON LEKA IV/a

E vonuar me shekuj (Lirisë)

*Eja, ngado që je e si je,
o gjaku im,
që unë të jem unë,
e mu ashtu si duhet,
të filloj kërkimin e ditës,
kur lehjet ma prishin gjumin.
Nën atë ritëm monoton
të pikave të shiut,
të pres, me një lëmsh mendimesh,
të cilave sapo ua gjej fillin, këputen.*

*Kot mundohem
për ta ditur si dukesh...
Nuk shoh dritën e agimit,
pas atij zgjimi të ankthshëm
në atë zhgënjim mëngjesor,
kur mundohem të gjej prehje ngushël-
luese.*

*Se do të arrish,
fare nuk dyshoj,
për këtë të betohem...*

*Dukem më shumë se i vdekur,
ndoshta do të rilindem dikur.*

*Dua të shuaj etjen e brengës,
etjen e dhembjes!*

*Eja, mos u vono,
edhe ashtu
e vonuar je, me shekuj...
Eja, duhet të vish,
Eja, të gjejmë atë që na humbi.
Eja, më hap derën e rënduar.*

Arsun Sopa IVa

Dr. Salih Abdul-hakkk

Besimi i singertë në Allahun është ilaçi më i mirë për sëmundjet e kohës sonë

Pa marrë parasysh që ekspertët deklarojnë se medicina është në gjendje të shërojë çdo sëmundje përveç vdekjes dhe pleqërisë, realiteti përgënjeshtrohet ato pohime dhe e jep një pamje krejtësisht tjetër. Kështu që çdo ditë ndeshemi me numër të madh të sëmundjeve të lloj-llojshme të cilat nga dita në ditë, gjithë e më shumë, degëzohen dhe përhapen. Ndër to, veçanërisht, dy kanë marrë vrull, psikostenia dhe psikopatia.

Instituti për kërkime (hulumtime) psikologjike në SHBA, nxjerr në statikën e saj se 80% e pacientëve që jetojnë në qytete të mëdha lëngojnë nga psikostenia. Psikologët pohojnë që rrënjët kryesore të këtyre sëmundjeve janë: neveritja, skepticizmi, urrejtja, për-buzja, zemërligësia, frika, dëshprimi, egoizmi, lak-mueshmëria. Besimi është ai i cili njeriut ia shton vetëbesimin, shpirtërisht e përgadit dhe e forcon për të gjitha provat dhe vështirësitë e jetës. Ai në të vërtetë, është fshehtësia e asaj kënaqësie dhe shëndeti të madh shpirtëror, të cilin e posedojnë besimtarët, si thotë zotri Willijam Ollen: "Besimi i singertë në Zotin është forcë e madhe shtytse e cila me asgjë nuk mund të matet, e as të arrihet me ushtrime".

Shkenca bashkëkohore njeriut i ofron të mira materiale por nuk mund t'i ofrojë mu atë që do t'i zgjojë ndjenjat e tij, ta bëjë të sigurt dhe të kënaqur. Ana e tij shpirtërore është lënë pas dore. Përsoni i cili është privuar nga besimi në Zotin xh.sh. më së shpeshti i është nënshtruar sëmundjeve të ndryshme shpirtërore. Këtë fakt të pakundërshtueshëm për nevojën e domosdoshme të kohës sonë, që të pranojë besimin e singertë në Zotin xh.sh., i cili do të ishte ilaçi më efikas i sëmundjeve ekzistuese, e vërtetoi edhe dr. Bol Ernest Adolf në librin "Argumentet e ekzistimit të Zotit".

Dr. Boll Ernest thotë: Kur i kam mbaruar studimet dhe u bëra mjek isha i bindur se me talentin dhe mundin

tim, me aplikimin e mjeteve dhe metodave bashkëkohore të medicinës, mund të arrij një rezultat të suksesshëm. Megjithatë, së shpejti kam hasur në vështirësi dhe në koincidence rrethanash kam kuptuar që më të vërtetë e kam lëshuar pa e njohur principin më kryesor të shkencave të medicinës, e ai është besimi në Zotin xh.sh.

Dr. Bol Ernest paraqet edhe rastin e vet me plakën të cilës ia ka shëruar thyerjen e kofshës. Shërimi ishte shumë i suksesshëm, indet trupore janë rritur me shpejtësi të mrekullueshme. Madje dr. Bol ka shpejtuar t'ia urojë dhe e lajërmoi që pas njëzet e katër orëve e lejon që të shkojë në shtëpi...

U befusua për të keq kur pas disa orëve mori vesh që plaka papritur ka pësuar krizë nervore...

- Për kohë të shkurtër plaka ka vdekur, jo për shkak të krizës, por zemra ishte në pyetje. Dr. Bol e shpjegon atë çast, duke thënë: kjo në mua ka ndikuar shumë. Përfundova se do të ishte absolutisht e pamundur të ndodhë ashtu diçka, poqëse plaka do të besonte në zotin, në të cilin do të mbështetej dhe do të besonte singërisht. Medicina mund t'i vendosë eshtrat e thyëra të kofshës, ndërkaq privimi i besimit të njeriut në Zotin xh.sh. dërgon në vdekje edhe sikur trupi të jetë plotësisht i shëndoshë.

Psikologu i famshëm prof. Jungu, përvojën e tij të pasur e rezymon dhe thotë "Në tridhjet vjetet e fundit m'u kanë drejtuar për këshillë shumë pacientë të cilët vuajnë nga psikopatia gati nga e gjithë bota.

Problemi te të gjithë ata pacientë, të cilët sapo kanë filluar fazën e dytë të jetës së tyre, 35 vjet e më shumë, ishte në atë se ishin të privuar nga besimi në Zotin.

Sa për ilustrim do të citoj edhe fjalët e dijetarit të mirënjohur E. Kraj MORISON, ish kryetarin e akademisë në Nju Jork, i cili thotë "Civilizimi ynë së shpejti do të vdesë (zhdukët, shfaroset), pa besim në Zotin. Për

këtë është më së e nevojshme ta forcojmë kontinuitetin dhe raportin ndaj Zotit".

Në të vërtetë nuk do të gjejmë ilaç efikas për sëmundjet e kohës sonë nga të cilat çdo ditë pësojmë, përveç nën mbrojtjen e besimit të singertë në Një të Vetmin ALL-LLAHU xh.sh.. Efekti më i madh i besimit është në atë se përmbush gjithë qenien njerëzore me një kënaqësi të posaçme dhe në atë se jetën ia bën më të rehatshme dhe më të lumtur. Ai jeton qetë dhe rehatshëm në harmoninë që e rrethon, i vetëdijshëm që kjo botë nuk është barrë që nuk mund të bartet, as nuk është vështirësi që nuk mund të tejkalohet.

Si do që të jenë, rrethanat jetësore nuk mund t'ia prishin kënaqësinë, qetësinë, dhe lumturinë e tij, sepse fjalët e Pejgamberit janë të vërteta, i cili thotë: "E çuditshme është puna e besimtarit. Secila situatë në të cilën bie për të është e burimshme. Diçka të tillë nuk posedon askush pos tij. Nëse përjeton ndonjë gëzim, është mirënjohës, e për të ajo është mirë, e nëse e godit ndonjë fatkeqësi, është i durueshëm, pra edhe kjo për të është mirë".

Me këtë kompensim spiritual të panjollë besimtari i mposht të gjitha vështirësitë dhe problemet me të cilat ballafaqohet. Kurdo që e godit diçka e pakëndshme, besimi i ofron ndihmë dhe ngushllim, ia kthen qëndrueshmërinë, vetëbesimin dhe qetësinë shpirtërore. All-llahu i Lartësuar thotë: "Ata të cilët besojnë kur e kujtojnë All-llahun, zemrat e tyre qetësohen. Ja, kujtimi i All-llahut, me të vërtetë, i bën zemrat të qeta".

Njerëzit që moti i kanë njohur dobitë e besimit, pasi që efektin e tij e kanë ndier tek ithtarët e tij, i shprehur në formën e kënaqësisë shpirtërore, sigurisë dhe vetëbesimit. Ata me vendosmëri përpiqen që jetën e tyre ta kalojnë në punë dhe luftë, që të bëjnë sa më shumë vepra të dobishme, pa marrë parasysh se në çfarë rrethanash jetojnë, duke u udhëhequr nga fjalët e të Lartësuarit All-llah: "Kush nga meshkujt e femrat punon mirë, e krahas saj është besimtar, do t'ia bëjmë jetën të rehatshme".

shqipëroi nga boshnjakishtja

IRFAN KRASNIQI

KL. IVb

SHOKUT TIM MARKSIST

*Provokator që dikur ishe,
atëherë moti
me pyetjet absurde:
a thua ku mund të jetë Zoti?
Perëndi e njerëzimit
thojë është Lenini
zotri Enveri
po edhe Stalini.*

*Pranoje vetëm materien
s'e njihje Muhammedin
për botën kishte vetëm një çelës
Marks, Lenin dhe Engels.*

*Marks, Stalini yt përëndi
dhe kapitali i tij
tretën si dëborë
ti mbete i gjorë.*

*Të lutem shoku marksist
mos u bë pesimist.
Bindju Muhammedit
përrulju Zotit
kërko amnesti
s'ka tjetër Përëndi.*

*Kur'ani është fjalë e Zotit
ndër shekuj qëndroi
thirrjen drejt Allahut
kurrë nuk e ndryshoi.*

*e punoi: Fatmir Latifaj III
Medresja e mesme "ALAUDDIN"
Prishtinë.*

Dijetarët joislamë dhe argumentimet e tyre mbi qenien e Zotit në baza shkencore - kosmologjike

* * *

Shkencëtarët, për të cilët do të flasim më poshtë, pothuajse të gjithë janë të njohur në sajë të gjurmëve të tyre të pashlyeshme në aspektin shkencor. Përveç arritjeve të tyre në këtë aspekt, rëndësi të madhe i kanë dhënë dhe argumentimit të qenies së Zotit, bazuar kjo në fakte shkencore kosmologjike. Njëkohësisht duke u bazuar në thëniet e këtyre dijetarëve do të zhvleftësohen dhe hudhen poshtë tezat e atyre individëve që e konsiderojnë fenë si rezultat i paditurisë dhe se, sipas tyre, me zhvillimin e njeriut dhe shkencës, me kalimin e kohës feja do të zhduket.

Me padyshim numri i dijetarëve që e argumentojnë ekzistimin e Zotit është tepër i madh, e ne po i përmendim vetëm disa prej tyre:

* * *

ALBERT AJNSHTAJN - është fizikanti i njohur, teorik gjemran, me prejardhje çifute. Jetoi në vitet 1879-1955. Më 1900 i kreu studimet në shkollën e lartë teknike.

Në periudhën 1902-09 shkroi punimet e tij të para me rëndësi nga lëmi i fizikës teorike, e posaçërisht është me rëndësi punimi i tij në teorinë speciale të relativitetit (1905). Përveç arritjeve të shumta të tij vlen të përmendet puna dhe kontributi i tij në zbulimin e bombës atomike. Vepra më e njohur e tij është teoria e relativitetit e cila prek edhe në koceptonet filozofike mbi hapësirën dhe kohën. Më 1905 ka futur hipotezën mbi kuantet e dritës të ashtuquajturat fotone, me çka ka kontribuar në zgjedhjen e një problemi kyç në fizikë - rrezatimi i trupit të zi. Në vitin 1921 fiton çmimin Nobel për fizikë. Megjithëse është fizikani më i njohur ai një vepër të tij e titullon "E kam shfrytëzuar vetëm 10% të trurit tim".

Ai thotë:

"Sa herë që bie në dëshim për ekzistimin e qenies së Zotit, menjëherë kthehem në laborator dhe vetë faktet dhe argumentet më dëshmojnë se vërtet ekziston Zoti i Madhërishtëm".

* * *

ISAK NJUTNI - njeriu prej më të njohurve në historinë shkencore. Ishte fizikant, matematikant, astronom etj. Jetoi në Angli 1642-1727. Mekanika si disiplinë e veçantë shkencore është themeluar po nga ky shkencëtar. Vlen të përmendet puna dhe arritja e tij në lëminë e optikës dhe matematikës. Nga të arriturat më të mëdha shkencore konsiderohet teoria e tij në lidhje me gravitacionin. Ai thotë: "Renditja korespondente e Diellit dhe e planeteve tjera ka mundur të ndodhë vetëm se i Gjithëfuqishmi ka dashur dhe e ka krijuar".

* * *

GALILE GALILEU - (1564 - 1642) është fizikant, matematikant dhe astronom i njohur italian. Pas kryerjes së medicinës i kushtohet studimit të gjeometrisë dhe veprave të Arkimit. Konstruktore termoskopin e parë, pastaj zbulon mënyrën si konstruktore dylbia optike. Me zbulimin e dylbisë fillon periudha e plleshme e hulumtimeve astronomike të Galileut. Si ihtar i flakët i sistemit të Kopernikut, Galileu ra në kundërshtim me doktrinat kishtarë, ku edhe pse pas premtimit të tij se do të tërhiqet nga bindja e tij në lidhje me sistemin heliocentrik, ai prapëseprapë e shfaq këtë sistem në veprat e tij. Për këtë shkak ai u persekutua në moshën 70 vjeçare nga inkuizicioni kishtar, i cili e përkrahte sistemin geocentrik, natyrisht të gabuar.

Pa dyshim vepra më e madhe e tij është ajo "mbi mekanikën" në të cilën e ka vënë bazën e mekanikës. Në këtë vepër e ka përpunuar rënien e lirë, e ka futur

nocionin e nxitimit, e ka përpunuar lëvizjen teposhtë rrafshit të pjerrët, hudhjen horizontale etj. Ai thotë: "E fëllënderoj Zotin pa kufi që më mundësoi t'i zbuloj këto çudira të mëdha të gjithësisë".

* * *

NIKOLLA KOPERNIKU - astronom dhe dijetar polak, i cili jetoi në shek. XV. Përpos studimeve të drejtësisë kishtarë, që arriti doktoraturën në këtë aspekt, ai i kushtoi rëndësi të madhe astronomisë. Ky dijetar, siç e cekëm më lart, është i pari që e vendoi teorinë e sistemit heliocentrik. Ai thotë: Kush mund të mos dorëzohet kah i Gjithëfuqishmi të mos kënaqet me Krijuesin e Gjithëfuqishëm të botës, nëse mendon se i Gjithëfuqishmi e ka krijuar gjithësinë".

* * *

ARTUR STANDEI EDINSTON - fizikant dhe astronom anglez. Jetoi në vitet 1882 - 1994. Ka qenë drejtor i opservatoriumit në Kembrixh. Përveç tjerash, është marrë me studimin e yjeve. Ka zbuluar masën, temperaturën mesatare dhe përbërjen e brendshme të shumë yjeve. Ai thotë: "Njohja njëra pas tjetrës mund t'i zbulojë të fshehtat natyrore, por asnjëherë nuk do të arrijë të shohë se si duket gjithësia. Njohjet moderne dhe astronomia patjetër duhet të kthehen te Zoti, sepse gjithësinë deri në fund e njeh vetëm Ai, i cili e ka paramenduar dhe krijuar.

Përveç këtyre dijetarëve, ekzistojnë edhe shumë e shumë të tjerë me mendime të këtylla, të cilët me të vërtetë është vështirë të numërohen por si përfundim i kësaj teme vlen të përmendet thënia e filozofit islam Farabiut (897-950) i cili thotë:

"Jemi të sigurtë se nuk ka argument më të fortë lidhur me çfarëdo çështje qoftë, se mendimi i shumicës, posaçërisht kur mendohet dhe analizohet thellë ajo çështje, sepse ndonjëri e përdorë rezonin dhe logjikën e vet, prandaj një mendje mund të gabojë shumë lehtë, kështuqë nevojitet t'i bashkojmë shumë mendje. Te ata që e kundërshtojnë mendimin e shumicës ekziston vetëm një mendim i një njeriu e që zakonisht ata e imitojnë atë..."

Prandaj pasi që të gjithë dijetarët e të gjitha kohërave e vërtetuan dhe e besuan këtë të vërtetë duke e përfshirë edhe mbarë njerëzimin gjatë gjithë historisë së tij, atëherë është e papërceptueshme që të gjithë këta të mashtrohen pas një të pavërtete dhe absurditeti.

Pra të ekzistuarit e qenies së Zotit është e vërtetë e pashmangshme dhe Ai është Krijues dhe Planifikues i çdo gjëje që ekziston, ku në një ajet kur'anor thotë:

"Ai është Allahu, Zoti juaj, Krijues i çdo gjëje".

Ilir Osmani Ila

DISA FJALË TË URTA TË IMAM ALIUT r.a.

1. Çdo shigjetë nuk e qëllon shenjën dhe çdo lutje nuk pranohet.
2. Kije kujdes gjuhën se ajo është si shigjeta që shpesh e gabon shenjën!
3. Shoku më i mirë është ai që ndreq gabimet tuaja.
4. Moshëria e punëve të këqia është më lehtë se të pendohesh pas.
5. Ai që flet shumë nuk shpëton nga gabimet.
6. Bëria mëkate është sëmundje, pendimi nga ato është ilaç, kurse shërimi është të largohesh përgjithmonë nga ato.
7. Eksperiencia është një mësues i madh.
8. Lumturia e vërtetë nuk është në pasurinë e madhe, por është në kulturën e lartë e moralet e pastra.
9. Kurora e ndonjë sunduesi duhet të jetë drejtësia.
10. Shpirti i diturisë është morali i lartë.
11. I mençuri flet kur është nevoja dhe arsyeja.
12. Unë nuk e ndjek atë që ik, por nuk iku nga ai që më ndjek.
13. Të falësh, kur ke mundësi hakmarrje, është kulmi i lartësisë morale.
14. I dituri e kupton të paditurin meqë dikur ishte si ai, por i padituri vështirë e kupton të diturin, pasi që kurrë nuk ishte si ai.
15. I ditur, me të vërtetë, është ai që veprat ia përshtat fjalëve të tij.
16. Zemra e të çmendurit është në gojën e tij.

Zgjedhi SANI AVDIU kl. IIb

IMAMUL A'DHAM - EBU HANIFE (Na'man ibni Thabit 80-150)

"Për çfarëdo çështje, së pari mbështetem në Kur'an, nëse nuk e gjej në Kur'an, atëherë mbështetem në hadithet e Pejgamberit a.s. e nëse nuk e gjej as këtu, atëherë veproj sipas thënieve (konkludimeve) të sahabëve. Prej tyre marr mendimin e atij që më pëlqen e i lë fjalët e tjetrit, porse nuk largohem prej fjalëve të tyre te të tjerët. Nëse çështja arrin te tabiinët, edhe unë bëj ixhtihad-angazhohem sikur ata".

Kush ishte ky njeri që i tha këto fjalë? Kush është ky njeri që në Kur'an, Hadith dhe fjalët e sahabëve qenkëshin mbështetja kryesore.

Të shkruash për një dijetar-alim të këtij kalibri është një përgjegjësi e madhe. Është kështu sepse është prej atyre dijetarëve të pakët mbi jetën dhe veprimtarinë e të cilëve u diskutua dhe u shkrua aq shumë sa që mund të gjejmë edhe vepra voluminoze.

Siç po shihet, për këtë dijetar të shquar ka çka të flitet mjaft, mirëpo në këtu do të mundohemi, që me pak fjalë të paraqesim dy elemente-komponentet kryesore që një dijetar të jetë me plot kuptimin e fjalës dijetar, e ato janë: dituria - ilmi dhe devotshmëria-takvallëku që nuk mungon aspak te kjo figurë e ndritur dhe e respektuar nga dijetarë të ndryshëm.

Dituria-ilmi i Ebu Hanifes

Njerëzit janë të ndarë në grupe, drejtime e fraksione të ndryshme. Jo vetëm që janë ndarë por edhe raportet mes disa njerëzve të ndonjë grupi ndryshojnë. Ashtu edhe raportet mes besimtarëve muslimanë dhe fesë Islame ndryshojnë. Ka prej njerëzve (besimtarëve) që Islami, me gjithë telashet dhe vështirësitë që i ka, prapëseprapë i bart mbi supet e tij, por fatmirësisht ka edhe të atillë që e bartin islamin mbi supet e tyre. Pa dyshim EBU HANIFE ishte njëri prej tyre.

Sipas pohimit të vet, Ebu Hanifen për t'u marrë me dituri-shkencë e kishte udhëzuar sha'biu, i cili i kishte thënë: "Unë te ti shoh zgjuarësi dhe zhdërvjelltësi, andaj shoqërohu me dijetarë".

Është interesant të theksohet edhe kjo se babai i tij, Thabiti kishte lidhje të ngushta me Aliun r.a. dhe sipas një rivajeti-transmetimi Aliu r.a. i bëri dua-lutje All-lahut xh.sh. që t'i falë fatbardhësi në pasardhësit e Thabitit.

Dëshiroi i Lartmadhërishti dhe e pranoi lutjen e Aliut dhe Thabitit i lindi djali të cilin e quajti Nu'man. Numanit, si fëmijë i dy prindërve të ruajtur nga haramet, për një kohë, relativisht të shkurtër, i del nami si dijetar i madh, ku njëherit i ngjiten pseudonime të shumta nga bashkëdijetarët e kohës së tij të cilat njëherit ishin edhe epitete të tija, si p.sh.: IMAMUL A'DHAM - imami më i madh, EBU HANIFE - babai i pastërtisë, FEKIHL IRAK -fekihu - juristi i Irakut etj.

Ebu Hanife, si fëmijë, mësoi Kur'anin përmendësh e sipas disa rivajeteve atë (hifdhin) e mësoi nga Imam Asimie që është njëri prej shtatë lexuesve (karive) të Kur'anit. Pastaj, i etur për dije, i rreket të mësuarit e shkencave Islame madje nga dijetarë të ndryshëm. Ilmul Kelami (APOLEGJETIKA ISLAME) ishte stacioni i parë serioz në të cilin u ndal dhe njëherit mësues e udhëheqës shpirtëror kryesor e kishte Hamadin, te i cili mësoi 18 vjet me radhë. Te ai, kryesisht, mësoi Ilmul Kelamin dhe fikhun - drejtësinë islame.

Biografët e tij theksojnë se ai ka mësuar prej 4000 dijetarëve qoftë ai mësim direkt apo indirekt dhe shtatë prej tyre kanë qenë sahabij, 93 tabiinë dhe të tjerët tebeitabin.

Është interesant të përmendet edhe ajo se Ebu Hanifeja, për problemet dhe dukuritë e reja si dhe për

pyetjet që kishin nevojë të studioheshin, kishte formuar institucion të veçantë prej 40 dijetarëve, të cilët ishin të specializuar në shkencat të ndryshme Islame, si fikh, tefsir, hadith, gramatikë, akaid etj.

Detyra e këtij institucioni ishte të shikojë problemin e paraqitur nga drejtimi i tij profesional dhe vetëm pas një autocenzure të këthillë aprovohej vendimi - fetvaja dhe atëherë e urdhëronte Ebu Jusufin ta shkruante atë.

Në rast se vështirësohej edhe më shtjellimi i ndonjë çështjeje, Ebu hanifes nuk i mjaftonte vetëm ky institucion, mirëpo ai u thoshte shokëve se mbase ka bërë ndonjë mëkat dhe kthehej e i lutje All-llahut që t'ia falë atë. Kishte raste edhe kur falte namaz të posaçëm, vetëm e vetëm që vendimi - fetvaja të jetë sa më e saktë.

Kur për këtë dëgjoi Fudejl Ibni Ijadi qajti shumë dhe me atë rast pat thënë: "kjo ndodhte sepse ai (Ebu Hanife) kishte mëkate të pakta, ndërkaq të tjerët kësaj nuk i vënin veshin".

Në fund duhet të ceket edhe kjo se tubimi-mexhlisi i Ebu haifes ka qenë tubimi i nxënësve të mëdhenj. Nuk kishte prezent prej masës së gjerë, por prej atyre të cilët kanë dëshiruar të bëhen dijetarë.

Pra, me një fjalë, Ebu Hanifja ishte deti në shkencat islame, si në: akaid, fikh, tefsir, hadith, gjuhë etj. e që nga këto dete ishte formuar një oqean i tërë dijeshe në të cilin gjenin ujë të pijshëm (dituri të pastërt islame) të gjithë ata që ishin të etur për të dituri.

DEVOTSHMËRIA (TAKVALLËKU)

I EBU HANIFES

Siç përmendëm më parë Ebu Hanife u lind prej dy prindërve të pastërt e të moralshëm të cilët, njëkohësisht, i dhanë temelin e devotshmërisë mbi të cilin u ngrit personaliteti i ndritur i Ebu Hanifes.

Ky dijetar mësonte e punonte shumë. Kishte regjim të stërngarkuar ditor të cilit i përballonte me vullnet të jashtëzakonshëm. Mbase falte sabahun, mësonte 3 orë, pastaj dilte në treg për t'u marrë me tregtinë e tij të mëndafshit. Prej ikindisë deri në jaci mësonte vetë dhe i mësonte të tjerët. Pushimi i tij i vetëm ishte koha prej

mbasdrekës deri në ikindi, sepse nata e tij nuk ishte kohë pushimi e fjetjeje, por ishte kohë ibadeti. Andaj aspak nuk duhet të çuditemi kur dëgjojmë se Ebu Hanifja 40 vjet rradhazi e ka falur namazin e sabahut me abdest të jaciesë.

Adhurimi për Zotin ishte para diturisë së tij. Ai falej gjithë natën dhe këndonte Kur'anin në dy reqate. Agjëroi shumë gjatë jetës së tij, ndërsa në haxh shkoi 55 herë dhe atë që nga mosha 15 vjeçare, kur kishte bërë haxhin e parë.

Shembulli i Ebu Hanifes, megjithë namazin e agjërimin e shumtë e vizitën e shpeshtë të Qabes, me një fjalë me gjithë ibadetin e tij të shumtë, i përngjan nxënësit të mirë i cili i nënshtrohet provimit të matematikës dhe përgjigjet në të gjitha pyetjet, por prapëseprapë frikësohet se mos, rastësisht, do të dështojë. Kështu ishte edhe Ebu Hanifja, frikësohej se mos All-llahu xh.sh. nuk do t'ia pranojë adhurimin e tij. Këtë më së miri e ilustron rasti që na e transmeton muezini i xhamisë së tij, i cili thotë: "E kam lënë Ebu Hanifen pas jaciesë ulur duke lexuar ajetin dhe prapë kur kam ardhur për të falur namazin e sabahut e kam gjetur po me të njëjtin ajet, vetëm se gjendja kishte ndryshuar, sepse tani mjekrra i ishte bërë çull nga lotët e tij.

Ky, pra, ishte Ebu Hanifja. Bujaria, modestia, devotshmëria, dorëlibërësia ishin cilësi të pandashme të tij. Dihet fare mirë se disa prej nxënësve të tij gjendja ekonomike u impononte mungesën në ligjërata andaj, që të mos largohen nga mësimi, ai i bënte pjesëmarrës në fitimin e tij. I tillë është rafti i Jakubit pastaj i Ebu Jusufit të cilëve u kishte siguruar paga vjetore dhe duke u thënë në fund se ajo është pasuri e tyre e jo ndonjë lëmoshë.

Kurrë nuk u lodh së bëri da'vet dhe kurrë nuk e uli zërin ndaj disa sekteve, si: muteziles, havarixhes, shias etj, duke u sjellë argumente nga Kur'ani e hadithi. Ai i luftoi me të madhe edhe natyralistët e asaj kohe, por atyre përkundrazi u sillte argumente mendore e logjike mbi ekzistimin e Zotit, ku, jo rrallë herë, bëhej shkaktar për islamin e tyre.

Ebu Hanifeja preferonte jetën e ardhshme dhe kurrë nuk u nis nga ajo që të fitojë ahiretin me dynjallëk por ta fitojë dynjallëkun me ahiret. Ai, njëherit, kurrë nuk iu lakmoi të mirave të kësaj jete. Këtë më së miri na

ilustron rasti i gatishmërisë së tij me halifin Mensur për të mos pranuar detyrën e gjykatësit suprem (kadil kudas). Kur Mensuri e kishte thirrur dhe i ofroi këtë pozitë, ai u arsyetua me pleqëri, atëherë halifi i tërbuar i thotë se po gënjen, e Ebu Hanifja i përgjigjet shkurt duke thënë se: "po çuditë me atë se si ju dëshironi të bëni një rrenacak gjykatës suprem të shtetit Islam!!? Me siguri, këtë nuk e bëri nga mendjamadhësia e as që ishte e ndaluar një punë, por vetëm nga shkalla e lartë e devotshmërisë. Për këtë shkak burgoset dhe pas torturave të mëdha lirohet. Thuhet se pas kësaj nuk jetoi gjatë dhe vdiq me 50 h. duke qenë në sexhde. Ky, pra, është Ebu Hanifja, shembull i vërtetë i devotshmërisë për të gjitha kohët.

Ç'thonë të tjerët për të?

Mjaft dijetarë të hershëm e çmuan Ebu Hanifen e ne do t'i përmendim vetëm disa thënie të tyre, si:

Thotë Vekiu - mësuesi i Imam Buhariut "Ka qenë besnik i madh, preferonte pëlqimin e Zotit xh.sh. mbi çdo gjë dhe do të duronte shpatat e drejta trupit të tij për ta ruajtur fenë".

Hermele ibni Jahja, sipas rrëfimit të El Hatibit, ka thënë: "Kush përpiqet të mbërrijë dituri detesh në shkencën sheriato-juridike dhe me këtë arrin, megjithatë ai me këtë shkencë mbetet sikur fëmijë kundër Ebu Hanifes".

Përveç këtyre dijetarëve, Ebu Hanifen e çmuan edhe prijësit e medhhebeve tjera si thënia e Imam Malikut, ku thotë: "Nuk kam parë njeri i cili do të ishte i barabartë me Ebu Hanifen. Kur të thonte se kjo shtyllë është prej arit do ta arsyetonte mendimin e vet. Gjithnjë ka pasur dëshmi aq të fuqishme dhe të pakontestueshme".

Imam Ahmed i thotë: "Në fikh ka qenë më bujari, preferonte jetën e ardhshme, ishte i pajisur me virtyte e mësimet Kur'anore".

Imam Shafiu thotë: "Njerëzit në fikh janë të varur nga EBU HANIFJA".

Dhe në fund po e sjellim thënien e imam Thevriut, i cili thotë: ai që e kundërshton Ebu Hanifen duhet të jetë më i aftë dhe më i ditur se ai; ndërkaq një gjë e tillë është e pamundur".

Nuk ishte qëllimi ynë që me këtë fjalë ta ngrisim aq lart Ebu Hanifen, sepse jemi të vetëdijshëm për pakryershmërinë e njerëzve, por qëllimi ynë ishte që t'iu ofrojmë lexuesve, sadopak, material mbi jetën e kësaj figure të ndritur Islame, si dhe t'ia tërheqim vërejtjen disa individëve, të cilët, pa pikë turpi, thonë se, kinse, Ebu Hanifja i paska ditur vetëm 17 hadithe apo se drejtimi i tij qenka i ndërtuar vetëm mbi këto 17 hadithe, e edhe disa thënie tjera të paskrupullta, si këto. Për demantimin e tyre do t'i përmendim vetëm disa argumente si:

1. Imam Dhehebiu (vdiq 748), mendimtar e kritik i njohur në veprën e tij *TEBEKATUL HUFADH*, e thekson Ebu Hanifen si hafidh.

2. Hatibi el Bagdadi transmeton nga Ebu Jusufi i cili kishte thënë: "Nuk kam parë askënd që më mirë e njihte të komentuarit e hadithit dhe përdorimin e tij, siç është Ebu Hanifja".

3. Muhammed ibn Muhammed el Havarizmi (vd. 665h.) ka tubuar të gjitha hadithet e transmetuara nga Ebu Hanifja, në një libër. Libri në fjalë është i botuar në Egjipt më 1326 h. dhe përmban 800 faqe të mëdha.

Këto ishin vetëm disa argumente që na u mundësua t'i cekim të cilat demantojnë thëniet e të lartëpërmendurve të cilët, njëherit na dhimbsen, sepse në gojë të tyre, fatkeqësisht, shejtani ka vendosur frenjtë e tij të ndyrë, ku edhe nuk turpërohen të thonë se edhe ne jemi njerëz sikurse ai!!! Këtë e thonë edhe përkundër hadithit të Pejgamberit a.s. ku thotë: Gjenerata më e mirë është ajo që më ka takuar mua (sahabët), pastaj ajo që i pason ata (tabiinët), pastaj ajo që pason ata (tebei tabiinët). E që fare mirë dihet se Ebu Hanifja ishte tabiin d.m.th. i takonte asaj gjenerate që e ka takuar pejgamberin a.s. por prapëseprapë "edhe ne jemi njerëz sikurse ai!!!

Për ne nuk mbetet asgjë tjetër veçse t'i lutemi All-llahut xh.sh. që të na i falë gabimet-mëkatet e shumta, neve dhe gjithë besimtarëve, të na bashkojë me të në Xhennetin Firdevs.

AFRIM BULLIQI

KL. IV/b

Isai a.s., zot apo i dërguar i Zotit?

I. Çka thotë Kur'ani?

Është e ditur se feja islame është monoteiste dhe Kur'ani e potencon shumë qartë se ekziston vetëm një All-llah:

"Zoti juaj është një, All-llahu? nuk ka zot pos Atij që është mëshirëplotë, gjithnjë mëshiron"

(2:163).

Çështja e Isait a.s. - Jezu Krishtit është e përmendur mjaft shumë në Kur'an. Aty tregohet edhe qëndrimi i të krishterëve ndaj këtij të dërguari të Zotit: "Ata thanë: 'Allahu ka fëmijë'!? I pastër është Ai nga kjo e metë! E Tij është gjithçka në qiej e në tokë, gjithçka i është nënshtruar Atij" (2:116).

Është e udhës të cekim disa ajete nga Kur'ani Fisnik për të kuptuar se çfarë qëndrimi ka feja islame për Isain a.s. dhe çfarë përgjigje i jep ajo pyetjes: "Jezu Krishti (Isai a.s.), zot apo i dërguar i Zotit?"

1. Një historiati i shkurtër i Isait a.s. është paraqitur në suren Ali Imran 45-55 e fillon kështu:

"Përkujto kur engjëjtë i thanë: 'Oj Merjeme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet, emri i të cilit është Mesih, Isai, bir i Merjemes i famshëm në dynja dhe ahiret dhe nga të afërmit (e Zotit)'"

(3:45).

2. Në Kur'an tregohen edhe ditët e fundit të Isait a.s. në këtë botë:

"Madje për shkak të thënies së tyre: 'Ne e kemi mbytur mesihun, Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut'. Po ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan, por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytjes së) tij, janë në dilemë për të e nuk kanë kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë. E ata, me siguri, nuk e mbytën atë. Përkundërazi, Allahu e ngriti atë pranë Vetes. Allahu është i plotfuqishëm, i dijshtëm"

(4:157-158).

3. Për të argumentuar se Isai a.s. nuk është Zot, por vetëm njeri, Allahu xh.sh. në Kur'an thotë:

"E mohuan të vërtetën ata që thonë se: 'Zot është ai, Mesihu bir i Merjemes'. Thuaju: 'Nëse dëshiron Allahu ta shkatërrojë Mesihun, birin e Merjemes, nënën e tij dhe gjithë ç'ka në tokë, kuish mund ta pengojë atë'?...."

(5:17).

4. Për ata që i mohojnë këto të vërteta të Kur'anit për Isain a.s., në Kur'an thuhet:

"E kush të kundërshton ty në çështjen e tij (Isait) pasi të është bërë e ditur e vërteta, ti thuaj: 'Ejani i thërrasim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, vetë ne dhe vetë ju, mandej sinjerisht të lutemi për mallkim, dhe mallkimin nga ana e Allahut ta hedhim kundër gënjeshtarëve'"

(3:61).

5. Në fund u bëhet apel të krishterëve:

"O ithtarë të librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thuani tjetër gjë për Allahun, përveç asaj që është e vërtetë. Mesihu Isa, bir i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjalë e Tij që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë nga Ai. Besone pra Allahun dhe të dërguarin, e Tij e mos thoni: 'Tre' (trini). Pushoni se është më mirë për ju. Allahu është vetëm një Allah; larg qoftë asaj që Ai të ketë fëmijë. Ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë është vetëm e Tij. Mjafton që Allahu është planifikues i pavarur"

(4:171).

Pas këtyre shembujve nga Kur'ani Fisnik u bë e qartë çfarë është e vërteta për të dërguarin e Allahut - Isain a.s.

II. Cilësitë e Zotit dhe cilësitë e njerëzve

Është e udhës t'i përmendim cilësitë e Zotit xh.sh. dhe ato të njerëzve, pasi që me anë të argumenteve biblike do të shqyrtojmë nëse është Isai a.s. (Jezuşi), Zot apo i dërguar i Zotit.

Sipas mësimëve të mirëfillta islame nuk ka Zot tjetër pos Allahut, i cili as nuk u lind, as nuk e ka lindur kënd, nuk ka shoq, i përhershëm, pa fillim, i gjithanshëm, pa mbarim. Ai është i plotfuqishëm, i gjithëdijshëm, si Ai nuk është askush, dëgjon, sheh dhe flet. Qëndron mbi arsh, sundon çdo gjë, nuk i nënshtrohet asnjë ligji.

Allahu i Madhëruar e krijoi njeriun si halif në Tokë, caktoi ligje për të. Njerëzit lindin, rriten, shumohen dhe vdesin. Kanë fuqi e dije të caktuar. Hanë, pinë, lodhen, flejnë, tronditen, qajnë, gëzohen, frikësohen, kanë të pamur, të dëgjuar të caktuar dhe të kufizuar. Iu nënshtrohen ligjeve të natyrës, që i ka krijuar Allahu i Madhëruar.

Cilat kushte i plotëson Isai a.s., ato cilësi të Allahut (I pastërt qoftë nga ato që ia mveshin), apo ato të njerëzve. Përgjigjen e Kur'anit e dimë, por të shohim se çka thotë për këtë Bibla-Dhjata e Re (Shkrimet Greke).

III. Lindja dhe familja e Jezusit (Isait a.s.)

1. Prejardhja e Jezusit: "...përsa i përket prejardhjes së tij njerëzore ishte pasardhës i mbretit David..." (Romakëve 1:3);

"Jezusi, Mesia, është pasardhësi i Davidit dhe Abrahamit..." (Mateu 1:1).

2. Gjinia e Jezusit: "Pas një jave erdhi koha për ta bërë synet foshnjën dhe ia vunë emrin Jezus..." (Luka 2:21).

3. Si lindi Jezusi: "Ajo ishte në prag për të lindur dhe vuajtjet e bën të klithte" (Apokalipsi 12:2)

4. Vendlindja: "Jezusi lindi në qytetin Bet-lehem në Jude..." (Mateu 2:1).

5. Profesionit: "A nuk është ai i biri i zdrukthëtarit?..." (Mateu 13:55).

6. Varfëria e Jezusit: "Jezusi iu përgjigj: Dhelprat kanë strofkat e veta dhe zogjtë çerdhet e veta, por Biri i njeriut nuk ka ku ta mbështetet kokën e tij për të pushuar". (Mateu 8:20).

7. Jezusi qytetar besnik i Çezarit: "...Atje do ta gjeshtë një monedhë. Merre dhe jepja për mua e për

ty" (17:27). Këtu është fjala për tatimin që i paguan Jezusi Çezarit si qytetar besnik i tij.

8. Babai i Jezusit: "...Është Jezusi nga Nazareti, i biri i Jozefit" (Gjoni 1:45).

9. Familja: "A nuk është ai i biri i zdrukthëtarit? Po a nuk i quhet e ëma Mari, e vëllezërit Jakov, Jozef, Simon e Judë?" (Mateu 13:55).

IV. Zhvillimi i Jezusit (Isait a.s.)

10. Zhvillimi i Jezusit: "...Jozefi dhe Maria u kthyen bashkë me Jezusin në Galile, në vendlindjen e tyre në Nazaret. Djali rritej e forcohej...(Luka 2:39-40); "Ndërkaq Jezusi rritej trupërisht, përparonte në urtësi..." (Luka 2:52).

11. Jezusi i pafuqishëm: "Nuk mund të bëjë asgjë nga vetja, por jap vendimin gjyqësor ashtu siç më thotë Ati..." (Gjoni 5:30).

12. Jezusi pa dijeni për kohën: "Por askush nuk e di ditën dhe orën kur do të ndodhë kjo-askush, as engjëjtë në qiell, as Biri; vetëm Ati e di" (Marku 13:32).

13. Jezusi nuk i di stinët: "Pa një fik, jo larg, që tashmë ishte me gjethe. Iu afrua për të shikuar nëse kishte fryt, por nuk gjeti gjë përveç gjetheve, sepse s'ishte stina e fiqu" (Marku 11:13).

V. Misioni i Jezusit (Isait a.s.)

Të gjithë e dimë se Gjon Pagëzori (Jahjau a.s.) i pagëzonte njerëzit, e ky pagëzim kishte kuptim rrëfimn e mëkateve dhe pendimin prej tyre:

"I pranoni publikisht mëkatet e tyre dhe Gjoni i pagëzonte në lumin Jordan" (Mateu 3:6). "unë po ju pagëzoj me ujë në shenjë pendimi..." (Mateu 3:11).

14. Jezusi pagëzohet: "Pastaj erdhi Jezusi nga Galileja në Jordan për t'u pagëzuar nga Gjoni" (Mateu 3:13).

Si mund të jetë misioni i Jezusit "Shpëtimtar i mëkatarëve" apo si mund të quhet ai "I pa mëkate" kur edhe vetë u pastrua nga mëkatet në lumin Jordan.

VI. Jezusi (Isai a.s.) profet racial?

15. Jezusi izrealit: "...Luani nga fisi i Judës dhe pasardhësi i Davidit korri fitoren..." (Apokalipsi 5:5).

16. Jezusi vetëm për izrealitet: "Por Jezusi tha: Zoti më dërgoi vetëm te kopeja e humbur, te populli i Izraelit" (Mateu 15:24).

17. Diskriminimi racial i Jezusit: "Këta të dymbëdhjetë, Jezusi i dërgoi me detyrën që vijon: Mos shkonit në vendet ku banojnë joçifutët as mos hyni në qytetet e Samarisë, por shkonit te kopeja e humbur, te populli i Izraelit" (Mateu 10:5-6).

18. Sipas ungjillit joçifutët janë qenër: "Një grua kananease, që banonte aty, iu afrua dhe filloi të bërtiste... Por Jezusi nuk iu përgjigj fare. Më në fund nxënësit ngulën këmbë: Shko që ta heqësh qafe, po bërtet pas nesh!... Jezusi iu përgjigj: Nuk është e drejtë të marrësh bukën e fëmijëve e t'ua nxjerrësh qenve!" (Mateu 15:22, 23, 26).

19. Jezusi mbret vetë i Jakobitëve: "...Zoti Perëndi do t'ia japë mbretërinë e Davidit, stërgjyshit të tij. Do të sundojë përgjithmonë mbi pasardhësit e Jakobit..." (Luka 1:32-33).

20. Titujt e Jezusit: "Mbreti i çifutëve" (Mateu 2:2); "Mbreti i Izraelit" (Gjoni 1: 49, 12:13).

VII. Jezusi (Isai a.s.) nuk është Zot

21. Jezusi i uritur: "Jezusi, pas dyzet ditë e netë agjërime, ishte mjaft i uritur: (Mateu 4:2). "herët në mëngjesin tjetër, Jezusi u kthye në Jerusalemin. Rrugës kishte uri" (Mateu 21:18).

22. Jezusi i etshëm: "Jezusi e dinte tani se çdo gjë mbaroi dhe tha: Kam etje!..." (Gjoni 19:28).

23. Jezusi i fjetur: "...Por Jezusi flinte" (Mateu 8:24).

24. Jezusi i lodhur: "...Jezusi ishte i lodhur nga udha e gjatë..." (Gjoni 4:6).

25. Jezusi i tronditur: "Jezusi përsëi u trondit..." (Gjoni 11:38).

26. Jezusi qanë: "Jezusi derdhi lotë" (Gjoni 11:35).

27. Jezusi trishtohet: "...E zuri trishtimi dhe duke u dridhur u tha: Kam një barrë që gati po më mbyti..." (Mateu 26:37-38).

28. Jezusi frikësohet: "...E zuri një frikë dhe duke u dridhur u tha..." (Marku 14:33-34).

29. Jezusi i dobët: "E iu duk një engjëll nga qielli dhe i dha fuqi" (Luka 22:43).

VIII. Jezusi (Isai a.s.) paqën apo luftën

Shumë sekte të krishtere si p.sh. Jehovistët predikojnë ardhjen e Mbretërisë së Zotit ku do të mbretërojë Jezu Krishti, i cili do të sjellë paqën. Se çfarë paqe do të sjellë Jezusi është çekur shumë qartë në Shkrimet Greke - Dhjatën e Re.

30. Jezusi sjell përçarjen: "Mos mendoni se erdha të sjell paqen në botë. Nuk erdha për të, por për t'ju sjell përçarjen" (Mateu 10:34).

IX. Fundi i imagjinuar i keq i Jezusit (Isait a.s.)

31. Jezusi vdiq: "Por Jezusi bërtiti me zë të madh e dha shpirt" (Marku 15:37); "Jezusi, Mesia, vdiq për ne, armiq të Perëndisë" (romakëve 5:6); "Kur erdhën te Jezusi, vunë re se ai tashmë kishte vdekur..." (Gjoni 19:33).

X. Isai a.s. (Jezu Krishti) vetëm i dërguar

Nga këta shembuj të marrë nga Dhjata e Re u argumentua plotësisht se Isai a.s. (Jezusi) është vetëm i dërguar i Zotit e jo Zot. Këtë e kishte thënë edhe personalisht para çifutëve:

"Dhe, kur Isai, bir i Merjemes tha: O beni israilë, unë jam i dërguar i Allahut te ju, jam vërtetues i Tevratit që ishte para meje dhe jam përgëzues (myzh-dexhi) për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!..." (Kur'an 61:6).

LULËZIM BLAKA- KL. IVa

Petku i çuditshëm, ku!?

Ne, dikur, jo vetëm që ishin të veshur me petkun obligues por karakterizoheshim edhe me veti të larta morale, të ruajtur nga veprimet amorale e jonjerëzore që i kundërshton çdo ligj në botë. Shumë predikues me ngulm qëndronin kundër kësaj (pra kundër heqjes së këtij petku islam), por si rezultat i kësaj u maltretuan. Sot kjo na duket shumë e çuditëshme, ngase sot quhet e prapambetur femra e cila mban mbulesën islame, edhe nëse është e arsimuar e obligimet e saja i kryen me nder. Këtu qëndron përgjigjja e predikuesve largpamës.

Nëse petku islam na qenka prapambeturi, e jo përparim, atëherë si është e mundur që francezet, të cilat më tepër se një shekull e gjysmë (nga viti 1830) u munduan ta asimilojnë Algjerinë, duke përdorur metoda të ndryshme, duke vrarë miliona njerëz, t'ua duan përparimin algjerianëve?

Ç'luftë ishte ajo, përveç kundër petkut islam të shumë të rejave algjeriane në Francë. Athua vrasja, qenka përparim?!

Në Kur'an thuhet:

"O bijtë e Ademit, ne krijuam për ju petk që mbulon vendturpësinë dhe petk zbukurues. Po petku i devotshmërisë është më i miri. Këto janë nga argumentet e Allahut, ashtuqë ata të përkujtojnë. O bijtë e Ademit, të mos ju mashtrojnë djalli, sikurse i nxorri prindërit e juaj nga xhenneti, zhveshi prej tyre petkun, që t'ju dalë në shesh lakuriqësia e tyre. Vërtet ai dhe shoqëria e tij ju sheh, ndërsa ju nuk shihni. Ne kemi bërë djallët miq të atyre që nuk besojnë".

El A'raf: 26,27

Me fjalët në citat: "Petku i devotshmërisë" nuk nënkuptohet ndonjëfarë veshje arabe, pakistaneze... me të nënkuptohet petku i besimit, petku i të devotshëmve, frika ndaj Zotit, turpi etj. Luftën kundër këtij petku nuk duhet kuptuar ndryshe vetëm si luftë kundër besimit, humbje e turpit.

Në citatin në fjalë nuk u përmend petku i çuditshëm. Zoti nuk krijoi petk të quditshëm, kreatorë të petkut të tillë janë bashkëpunëtorët e djallit që gjithnjë munden ta zhveshin njerëzimin.

Nën këtë petk duhet të kuptojmë atë që është e ndaluar, atë që nuk i ka hije njeriut, si: mbajtja e pantallonave të shkyera, të leckosura me dëshirë, gjithashtu edhe të ngushta, veshja e petkut me lloj-lloj fotografi, flamuj të huaj (madje atë që nuk shkruajnë - vizatojnë fabrikat e tekstilit, bartësit e këtij petku e bëjnë vetë), mbajtja e mëndafshit, arit, hekurave të ndryshëm për meshkuj (duhet ditur se nuk janë kafshë), pastaj ndodh që të shohim meshkuj me tre-katër vathë në një vesh dhe në hundë, veshjet tekanjoze të femrave, si: pantollona të ndryshme të ngushta, sako të shkurtëra, apo fare të lakuriquara etj.

Pra, të tillët nuk dëshirojnë të bëhen elegantë, por duan të duken sa më të çuditshëm, këtu pra bëhet fjalë për snobizëm.

Jam më se i sigurt se këta herë pas here qeshin me vëten, fotoalbumet gjithnjë do t'i kenë në ndihmë, në to do të shohin modelet e vjetra të veshjes, e do të qeshen ngase e sotmja ju duket më e mirë, e përsosur. Unë shpresoj se këta nuk do të harrojnë dhe se përsëri do të fotografohen, pas një kohe shumë të shkurtër, do t'u shërbejë për humor.

S'duhet të lejojmë që të na ndodhë kjo, ne jemi graduar me titullin njeri, e për të qenë njeri duhet jemi të veshur me petkun e njeriut, s'guxojmë të jemi miq me djallin. Ne jemi të pastër e miqësia me të papastërtit nuk na takon.

Arsim Sopa IVA

"ZEMRËN E KAM TË PASTËR"

Në ndonjë tubim fetar, ku bëhet fjalë për iman, për namaz, për agjërim ka prej atyre që thonë: O vëlla, myslimanizmi nuk është vetëm namaz, apo vetëm agjërim. Ti shiko në zemrën time. Zemrën e kam të pastër, asnjë të keqe nuk kam, sillem mirë me rrethin tim dhe shumë punë të mira i punoj - kështu thonë ata.

Këso fjalësh me të vërtetë janë të përhapura në treg të fjalëve, edhe pse janë të pabaza dhe të paargumentuara dhe fliten pa dije e larg dijes.

Me të vërtetë Islami nuk është vetëm agjërim apo të falur. Feja, Dini i Allahut të lartësuar është një fe e lavdëruar, e cila përfshin të ardhmen dhe të kaluarën, dunjanë dhe ahiretin. Është ligj i Allahut.

Ne myslimanët, e sidomos shqiptarët, duke mos jetuar sipas moralit Islam, nuk mund të jemi pasqyrë për të tjerët. Për këtë arsye ne, fatëkeqësisht, nuk e njohim drejtësinë e fesë Islame. Në një anë ka prej atyre që pa i studiuar pesë kushtet e fesë, thonë: "MOS SHIKO QË NUK FALI NAMAZIN DHE NUK AGJËROJ, POR ZEMRËN E KAM SHUMË TË PASTËR". Ç'mbetet tjetër, pra? Punë të mira dhe ndihma mjedisit. Por këto punë i kryejnë edhe jomyslimanët. Ai që i thotë vetës mysliman, me çka dallohet prej atij jomyslimanit? Ata nuk falin namaz, ata nuk ikin prej ndalesave të Allahut, por as ne. Mirëpo pyes, vallë, athua çfarë dallimi kemi prej jomyslimanëve? Që të jetë njeriu besimtar i Allahut nuk është kusht i vetëm që ta dëshirojë të mirën, apo vetëm të punojë vepra të mira.

Nëse pa iman, pa namaz, pa agjërim, vetëm me simpatinë ndaj të së vërtetës dhe punëve të mira shkohet në xhennet, atëherë më së pari do të shkojë Edisoni e më pastaj Nikolla Tesla që zbuluan rrymën elektrike dhe ndriçuan botën. Punë më të mirë dhe më të dobishme a mund të ketë? Nëse Edisoni nuk ka besim në Allah dhe nuk ka ibadet edhe zbulimi i tij nuk do t'i ndihmojë.

Por edhe një njeri që ka ndërtuar një xhami, por pastaj ka dalë prej imanit, prej feje, jo vetëm një xhami por edhe njëmijë xhamia, nuk do të kenë dobi. Do ta shijojë dënimin. Sepse haku më i madh në sipërfaqen e dheut është imani e pastaj namazi. Pa këto dy të mira, sa do që të ketë të mira, nuk do të ketë dobi. Të gjitha këto punë të dunjasë dhe punë të mira dhe jeta e fëmijëve tanë, është që t'i shohim rezultatet e punëve në ahiret dhe për ta fituar xhennetin. Ka të shumtë që e kanë merituar xhennetin me namaz dhe iman dhe pa

e pa rrymën e pa ndërtuar xhami, por pa iman dhe i namaz askush. Ju lutem sikur vëllai i juaj, mos i çmo ato sende që nuk mund të na ndihmojnë pas vdekje. Kend mund ta gjeni më punëtor se sa bletën, se lopë se delët apo të ngjashme? Bleta me kilometra flutur lule mbi lule për të mbledhur nektarin dhe për të i dhuruar mjaltin. Edhe lopa, edhe delja duke kullot nëpër fusha dhe male, duke i shkyer buzët nëpër ther dhe në fund duke na përgatitur qumshtin dhe mish për ne. A ka mirësi më të madhe se kjo?

Domethënë se nuk është e mjaftueshme vetëm themi "E KAM ZEMRËN E PASTËR" dhe punë vepra të mira, sepse edhe pabesimtarët punojnë vepra të mira, por edhe shtazët.

Ky rast iu paraqit edhe Pejgamberit tonë të dashur p një popull që kanë thënë kështu, ai tha: Po t'i kishin zemrë dhe qëllimet e mira do t'i kishin edhe veprat-ibadetet.

Të mos harrojmë se shpeshherë dëgjohen edhe kë fjalë: "Ai është njeri i mirë, por namazin nuk e fal" "Unë jam shumë njeri i mirë, zemrën e kam të pastër askujt nuk ia mendoj të keqën, vetëm një të keqe e kam që nuk e fali namazin".

E këtyre që thonë: "Shiko në zemrat tona" ne tregojmë një shembull: Një njeri pa lexuar dhe pa krye fakultet, dëshiron të bëhet mjek.

- Kur i thuhet eja hyn në provime të mjekësisë, ai thotë "E shiko në zemrën time. Unë kam shumë dëshirë të madhe për këtë lëmi dhe aq shumë dëshiroj të jam mjek. sa që nuk mund ta matni". Dhe prapë thotë me kryelartë "ju sa do që të mësoni, unë më përpara do të bëhem mjek Edhe ata që nuk falen thojnë kështu: "Ju vazhdoni namazin. Unë nuk falem dhe nuk i kryej urdhërat Allahut, por ashtu e kam besimin më të madh tek Allah dhe më përpara se ju do të hyj në xhennet".

Të ishte fituar xhenneti pa namaz dhe pa ibadet, nuk do të thonin edhe ata që falin namazin "Ç'na duhet namazi?". Ose "Zemrën e kam të pastër" dhe gjith këto vepra të mira ia kishim lënë zemrës.

PRA, NUK MUND TË THUHET SE UNË E KAM ZEMRËN E PASTËR.

Mos harroni se xhenneti nuk është një vend pavlefshëm dhe i lirë, por edhe xhehennemi është nevojshëm!

E përgatiti për shtyp Fatmir Latifaj kl. II

Literatura: "Përse namazi

Origjina dhe fillet e gjinisë njerëzore (Pranë një zbulimi senzacional arkeologjik)

Zbulimi i arkeologut të shquar musliman me origjinë pakistaneze dr. Ibrahim Shahut, ndoshta, do t'i mohojë të gjitha teoritë e deritashme që flisnin për fillet dhe për zhvillimin e gjinisë njerëzore.

Arekologu më autoritativ pakistanez dr. Ibrahim Shah, në bashkëpunim me një grup arkeologësh anglezë, bëri një zbulim, i cili do t'i mohojë të gjitha teoritë, qoftë atë e Darvinit apo të tjera për fillet dhe për zhvillimin e llojit të gjinisë njerëzore.

Ekipi i dr. Shahut, i cili gëzon autoritet dhe prestigj të madh në arkeologjinë botërore, në vendin e quajtur Podvor, në afërsi të Ravalpindit, zbuloi një vegël prej guri, e cila në shikim të parë nuk dallonte shumë nga veglat e ngjashme të zbuluara deri më tash në vise të ndryshme të botës. Mirëpo është senzacional pohimi se ajo u gjet në një shtresë të tokës, për të cilën me metoda të përpikta shkencore, është konstatuar, me siguri, se është e vjetër - 2 milion vjet.

Në rast se me zbulime plotësuese vërtetohen hipotezat e matura, të cilat i inspiroi ajo vegël, atëherë kjo do të thotë se njeriu i parë do të kishte jetuar në luginën e Lumit Ind, në teritorin e Pakistanit të sotëm. Do të vërtetohej edhe diq më shumë e me siguri shumë më e rëndësishme - se gjinia njerëzore - lloji i njeriut (homo sapien) është shumë më i vjetër se sa që mendohej dhe vërtetonte deri më tash teoria e Darvinit.

Në radhët e opinionit pakistanez për këtë zbulim, i cili edhe po qe se nuk dëshmohej, ka tingujt e senzacionit, po flitet - fare pak dhe me rezervë. Në një emision televiziv, në orët e vona të natës, ku me shpjegimet e dr. Shahut, u prezentuan edhe veglat e zbuluara, e një dy-tri gazeta të përditshme e regjistruan këtë edhe në faqet e tyre.

Arsyet e kësaj rezerve do të duhej kërkuar sa më shumë në seriozitetin shkencor të dr. Ibrahim Shahut, i cili nuk dëshiron senzacion pa dëshmi e fakte të forta, po aq edhe në karakterin e shoqërisë së sotme pakistaneze. Religjioni dhe politika zyrtare e ashtuquajtura - politika e islamizmit të shoqërisë - tash disa vjet me radhë janë pjesë, bazë kryesore e jetës së përditshme në Pakistan. E dihet mirëfilli se feja - religjioni dhe toritë e Darvinit mbi evolucionin, se (prej majmunit deri te njeriu), kurrë dhe asnjëherë nuk janë pajtuar dhe nuk kanë gjetur gjuhë të përbashkët.

Se për çfarë zbulimi është fjala, më së miri do të tregojë pasqyra e zbulimeve arkeologjike, deri më tash më të rëndësishme, në këtë fushë. Para disa vjetësh senzacionin në botë shkaktoi zbulimi i eshtrave të stërgjyshërve të nejrut në vendin e quajtur Keni. Ata eshtra janë të vjetër 1,5 milion vjet, vetëm se këtu nuk

është fjala për (homo sapiensin), por për (homo erectuesin), qenie kjo, e cila ecte drejt dhe e njihte zjarrin. homo sapiens, sipas kriterëve arkeologjike, është stërgjyshi i parë i njeriut i cili punonte vegla prej gurit.

Nëse dëshmohej zbulimi i dr. Shahut dhe po qe se vegla e zbuluar është punuar përnjëmend para dy milion vjetësh, kjo do të thotë se qeniet nga lugina e Indit, jo vetëm që janë gjysmë milion vjetë - më të vjetra se Homonoidi në Keni, por edhe se njeriu ka shëtitur nëpër planetin shumë më përpara se sa që ka mund të supozohej sipas teorive të deritanishme. Sepse të gjitha teoritë e deritashme prezente thonin se qeniet, të cilat punojnë vegla (homo sapiens), janë në Tokë para një dyzet mijë vjetësh.

Zbulimi në Pakistan sjell edhe një dilemë. Çarlls Darvini në shekullin e kaluar ka shkruar, e këtë të gjithë e kanë miratuar deri më tash, se paraardhësit tanë të parë - me siguri, do të kenë jetuar, si thoshte ai, diku në Afrikë, athua vallë qeniet nga lugina e Indit, vetëm përmes rrugës që e dinin vetëm ata, kanë migruar në Afrikë para një milion e sa vjetësh?

Dr. Ibrahim Shahu edhe vendzbulimi i madh në Potvor, nuk janë të panjohur në botën e arkeologjisë, dhe kjo, këtij paralajmërimi, sado i matur që të jetë, i jep peshë dhe kuptim të plotë. Në të njëjtin vend i njëjti shkencëtar, dr. Shahu, që në vitin 1976 ka zbuluar një nofull të poshtme të ruajtur mirë të një qenie, që ka jetuar para nëntë milionë vjetë. Është miratuar hipoteza se ajo qenie, e quajtur Ramapithecus-Pengjabikus, është Humanoidi më i vjetër i njohur në shkencë si (stërgjysh i përbashkët i - njeriut). Konkludimi më interesant i shkencëtarëve, në bazë të asaj nofule të poshtme, ishte - se ajo qenie ishte ushqyer më ndryshe shumë se sa majmuni, e kjo është më se e vërtetë dhe e konstatuar në bazë të formës - konstruktit dhe renditjes së dhëmbëve.

Së shpejti, fill pas kësaj, dr. Shahu me bashkëpunëtorët e tij zbuluan kafkën e një qenie, e cila në Luginën e Indit ka jetuar para tetë milionë vjetësh dhe e quajtur simbas arkeologëve Sivapithecus Indicus. Këto dy zbulime forcuan edhe më tutje reputacionin e dr. Ibrahim Shahut, por njëherit përqëndruan vëmendjen arkeologët botërorë në vendzbulimin Potvor ende të pa analizuar dhe studiuar sa duhet.

Zbulimi i tashëm i veglës prej guri në një shtresë të tokës së vjetër dy milionë vjet, pa dyshim, do të shkaktojnë debitime të vullshme shkencore në mesin e arkeologëve anekënd botës. Mirëpo, ky zbulim vërteton se shpatitë që gjenden ende të pa studiuar të majës më të lartë të planetit tonë, Himalajeve, janë gurë të vërtetë të njohurive të fshehura për zanafillën e qenies njerëzore.

Bahri Gashi KL. IV/b.

Dituria, fryt i agnazhimit

"Dituria është gjë e humbur e besimtarit, ku ta gjejë duhet ta marrë". (Transmeton Termidhiu).

Dituria thërret angazhim. Kjo është pasqyrë e punës së njeriut. Njeriu i ngacmuar nga shumë faktorë objektiv e subjektiv ai përpiket që të gjejë mënyrën se si t'iu bëjë ballë apo edhe t'i mposhtë ngacmuesit e psikikës së tij. Ai përpiket të gjejë metodën për rezistencë, por gjithherë anon nga ajo më e lehta.

Përtacia aq shumë gjen shprehje në mendjen e njeriut sa që njeriu gjatë tërë jetës së tij nuk arrin ta shfrytëzojë mendjen e tij në njohje, përveç në një përqindje shumë simbolike. Domethënë njeriu i mungon angazhimi i duhur dhe si rezultat i kësaj del se ai është nën shkallën e optimale sa i përket zhvillimit intelektual. Për të qenë njeriu i mbërrirë duhet t'i paraprijë zgjuarësia që nga mosha fëmijërore, kur ende është nën kujdesin e prindërve. Prindërit janë të obliguar dhe janë përgjegjës për edukimin e fëmijëve të tyre ngase Muhammedi a.s. thotë: "Ju të gjithë jeni kujdestarë dhe të gjithë do të përgjegjeni për atë që ju është dhënë në ruajtje-përkujdesje". (T. Buhariu). Pra kujdestarët e parë të tyre janë të obliguar të kujdesën për: sjellje, edukatën e tyre etj.

Tham edhe më parë se njeriu për t'i ikur ngacmimeve të shumta ai zgjedh metodën më të lehtë për kundërvënie. Mirëpo në qoftë se ngacmueshmëria ka karakter më të ndërlikuar atij i nevojiten njohuri më të gjera lidhur me atë çështje që ballafaqohet. D.m.th. neglizhenca e tij e shpie në vuajtje, e vuajtjet e detyrojnë të angazhohet, ndërsa angazhimi shpie deri te sukcesi.

- Sa i përket faktorëve objektivë mund të themi se ata janë rrejdhim i kohës, që njeriun e detyrojnë medomos të angazhohet e të mos mbes prapa në shoqëri. Njeriu duhet ta ketë vendin e merituar në shoqëri dhe të jetë i barabartë në të gjitha poret e jetës me rrethin ku jeton.

- Sa i përket subjektivitetit duhet ditur se njeriun e bren një ndjenjë e brendshme që mund të ketë karakter jo të mirëfilltë (ziliqar) por mund të ketë karakter emocionues dhe shpresëdhënës.

Zilia gjen shprehje të njeriut sepse atë gjithnjë e bren përparimi i tjetrit. Edhe pse kjo gjë (zili për përparimin e tjetrit) nuk është e lejuar prapë ajo gjen shprehje te ai. Po të kufizohej vetëm në pikat e lejuara por edhe të

preferuara të zilisë do të ndikonin pozitivisht te ai. Pikat të cilat Muhammedi a.s. i lejoi ku thotë se: "Njeriu nuk guxon të ketë zili përveç ndaj dy njerëzve, njeriut të cilit Allahu i jep pasuri dhe atë e shpenzon në rrugën e drejtë, dhe njeriut të cilit Allahu i jep dituri dhe ai me atë vepron dhe i mëson të tjerët". (transmeton Buhariu) njeriun e mbushin kureshtje për angazhim maksimal për t'i arritur këto dy gjëra.

Nga kjo që thamë deri më tani bëhet e qartë se ngacmuesit që lënë gjurmë në psikikën e njeriut janë: Koha (Përparimi i shoqërisë me kohën), zgjedhja e metodave për evitimin e problemeve, zilia (në pasuri dhe dituri) etj., që nxisin për angazhimin dituror.

Si mjet tjetër për angazhim megjithëse njeriu është i ballafaquar me probleme e sakrifica të ndryshme është edhe shpresa. Ajo është mjet më i fort i cili njeriut i forcon bindjen dhe i jep kurajo drejt ecjes para në të gjitha lëmenjtë, veçmas atij dituror i cili nuk mund të blihet e as të fitohet ndryshe përveç me angazhim, e çdo angazhim ballafaqohet me sakrificë. Shpresa është metoda që i jep njeriut vullnet të fortë për angazhim e që shpie deri te qëllimi final.

Për sa i përket angazhimit njeriu shfrytëzon gjithë vullnetin e tij, mirëpo vullneti i tij është i larmishëm dhe nuk mund të përkufizohet në një lëmi të caktuar studimi.

Kultivimi i diturisë arrihet (bëhet) me të lexuar. Shkenca bashkëkohore (koha e kumpjeterizmit) ende nuk arriti të definojë apo të zgjedhë ndonjë mënyrë tjetër për kultivimin e diturisë, por medomos iu nënshtrua në mënyrë të verbër dhe ironike ligjit të Zotit xh.sh.

Zoti urdhëroi qysh para 14 shekujsh që ta zbatojë urdhërin e tij hyjnorë, ku thotë:

"Lexo, mëso, studio në emer të Zotit tënd që krijoi çdo gjë".

(El-Alek 1)

Nga e tërë kjo që u citua më lart mund të konkludojmë se dituria dëshiron angazhim të vazhdueshëm sepse edhe vetë ajo është rezultat, rrjedhim, pasqyrë dhe fryt i saj, mirëpo duhet pasur kujdes për mbrojtjen nga dëmtimi dhe shkatërrimi i saj sepse Muhammedi a.s. thotë:

"Fatkeqësia e ditursë është harresa, kurse ajo që shkatërron diturinë është të dhënit e saj atij që nuk i është besnik!".

Adem Breznica kl IV-a

M. Fethulla Gylan

Belaja e gjuhës

- Të folurit e shumë është një sëmundje që merr shkak nga çekulibri i mendjes dhe i shpirtit. E pëlqyeshme është ajo fjalë që me rrugën më të shkurtër, pa i turbullaur kokën bashkëbiseduesit, mund t'i shprehë atij diçka. Për t'i treguar diçka bashkëbiseduesit s'është e domosdoshme një bisedë e gjatë, në të kundërt bashkë me bisedën e gjatë vijnë edhe një sërë të këqijash...

- I mençur është njeriu që, në vend që të flasë vetë, u jep mundësi të flasën personat që janë të dobishëm për të tjerët dhe për vetë atë...

- Të flasësh pak e të dëgjosh shumë janë shenja virtyti dhe pjekurie, ndërsa dëshira për t'u dëgjuar vazhdimisht vetë, edhe nëse s'konsiderohet si një veprim djallëzor, s'ka dyshim se është, absolutisht, një çekuilibr dhe paturpësi...

- Njeriu e tregon veten me fjalët që thotë dhe me sjelljet reflekton nivelin shpirtëror. Llafazanët që s'ia lëshojnë fjalën kurkujtë, sikur çdo e thënë e tyre të ishte patjetër e nevojshme, me kohë fitojnë neverinë dhe përbuzjen e gjithë miqve. Kurse kjo situatë sjell si pasojë që të priten me tallje fjalët e bukura dhe të vërtetat e larta, me që i thotë një llafazan dhe kjo do të thotë mungesë respekti ndaj tyre.

Gruaja dhe familja

- Gruaja është mësuesja e parë e shkollës së njerëzimit për rritjen dhe edukimin e fëmijëve, për rregullin, harmoninë dhe paqën e familjes.

- Shtëpia që ka një grua të ndershme, të edukuar dhe të lidhur pas folesë së saj, është si një çoshe parajse...

- Çdo pikëpamje e mbrojtur deri më sot nga feministët në emër të grave, i ka çuar ato në manifestimin e sjelljeve të këqia, ua ka minimizuar personalitetin dhe ua ka deformuar natyrën. Përkundrazi, femra është një hallkë shumë e rëndësishme e zingjirit të qenies dhe aspekti më i rëndësishëm i saj është të qëndruarit brenda kufijve të krijimit dhe të natyrës së saj...

- Nëna dhe babai janë dy qeniet e shenjta që do të respektojnë, së pari, njeriu. Kush nuk i respekton ata ka dalë kundër DREJTËSISË. Kush i mundon ata, herët a vonë, do t'i nënshtrohet vetë mundimit.

- Femra, ashtu siç nuk është një enë e ndyer ose një copë metali i pavlerë, nuk e ka vendin tek enët e ndyra ose tek grumbulli i copave të metaleve të pavlera. Ajo është një margaritar i pashoq, prandaj, pa diskutim, duhet ruajtur në kuti margaritarësh.

Dituritë dhe shkencat

- Dituria, duke u bashkuar me urtësinë, fiton një thellësi që të merrë mendtë..

- Të kuptosh është tjetër gjë dhe të dish tjetër; mirë është të kuptosh sesa të dish.

- Mësoje vetën të thuash *nuk di*, ashtu që një ditë të mos turpërohesh duke thënë *nuk di*.

- Nevoja është udhërrëfyese e syprhtë e shpikësve.

- Injoranca është shoku më i keq, dituria-bashkudhëtari më besnik.

- Ashtu siç organizohen gara për shumë gjëra, po të organizohesh edhe gara e gjërave të mjera, injoranca do të zgjidhë princesha e saj.

(marrë nga libri "Kriteret ose dritat e rrugës")

zgjidhi IRFAN KRASNIQI KL. IVb.

KËNAQËSIA NË MUAJIN E BEKUAR

Muaji i Ramazanit, muaji i shpresës, i mëshirës, i paqës dhe i dashurisë ndaj Krijuesit të gjithësisë, na mundësoi që zemrat tona të bëhen të mëshirshme dhe të interesuara për ta njohur Dinin e të Madhit Allah xh.sh..

Agjërimi i Ramazanit tek disa persona arriti shkallën e duhur që e kërkon ai nga agjëruesi. Plurale u bënë zemrat që kanë mëshirë. Të gjithë ishin të gëzuar e sidomos të rinjtë tanë, të cilët entuziazmi emocional për Islam u shtua. Si çdo medresant, edhe unë e kisha të njëjtin fat, që këtë muaj ta pres në mesin e xhematlinjve, duke kryer detyrën e imamit.

Në këtë Muajin e bekuar isha në regjionin e rrafshit të Dukagjinit. Isha në fshatin Gjurgjuvik i Vogël, në komunën e Klinës së Begut. Me të vertetë, kjo anë, sidomos kjo komunë, me fshatra përrreth ndien mungesë për kuadra fetare. Si në çdo anë ashtu edhe në këtë fshat, ku shërbeva si imam, të rinjtë tanë ishin të interesuar për t'i njohur parimet bile edhe kushtet më elementare të fesë islame.

Ditët kalonin e dashuria e flakët e të rinjve shtoej për Islam. Posa e fillova aktivitetin e imamit, kërkoja që gjatë ditës të punoj për mësimbesim. Në këtë kërkesë xhemati menjëherë u përgjigjen. Prej ditëve të para të agjërimit e deri në ditën e fundit kam pasur të interesuar për mësim-besim, që nuk kam pasur vetëm një gjeneratë por kam pasur të moshave të ndryshme. Mua më gëzoi dhe më bëri të lumtur që të gjithë e donin islamin dhe donin të dinin më shumë për të. Fshati ishte bujar dhe fisnik. Këtë e them, jo pse mund të them, por pse e meritojnë. Çdo mosmarrëveshje ata e zgjidhinin bashkarisht. Fshati nuk kishte xhami. Por namazet i falnim nëpër shtëpia të xhematlinjve (nëpër oda). Koha kalonte shumë shpejtë. Gati tërë ditën e kaloja me të rinjtë të cilët pajiseshin me njohuri nga thesari i pafund i Kur'anit dhe synnetit të Muhammedit a.s.. Gjatë tërë muajit isha i kënaqur me sjelljen dhe dashurinë e flakët të fshatarëve ndaj fesë islame. Rinia ishte e panjohur për gjërat më themelore për islam, siç ishin: pastrimi, abdesti, namazi etj.. Në maksimum mundohesha që të jem sa më i afërt me fshatarët dashamirë. U befasova shumë kur dëgjova që në namaze po prezentojnë edhe arsimtarë e edhe profesorë të lëmenjve të ndryshme. Ata kërkonin edhe literaturë të ndryshme islame. Për-

shtypjet e mia për këtë mision nuk i harroj por nuk mundem t'i krahasoj me diçka tjetër.

Koha kalonte dhe nuk kishte të ndalur. Si filloi ky muaj, që na gëzoi të gjithëve për ardhjen e tij, ashtu edhe u përfundua. Në natën e fundit, kur kishin ardhur të gjithë për t'u përshëndetur me mua, ata ndienin një dhëmbje që po largohem nga gjiri i fshatit bujar. Dhe në fund kur koha ishte afruar që të largohem, kishte mbretëruar një heshtje që të gjithëve na kishte kapluar. Këtë heshtje, që u mërzita prej saj, e theu një djalë i vogël duke më thënë, disi përvajshëm: Hoxhë, mos na harro dhe në Ramazanin e ardhshëm, eja prapë!

Kaloi Ramazani, muaji i cili thërriste për shpërblime, për bashkim dhe solidarizim të muslimanëve. Shpresojmë se do ta kemi fituar në këtë Ramazan. E lusim Allahun e gjithësisë që pas këtij muaji të bekuar ta shtojmë aktivitetin tonë në Davet.

Inshallah. Nëse do Ai na i pranon qëllimet dhe veprat tona.

E përgatiti: Fatmir Latifaj, kl. III

AFORIZMA

1. *I miri vdes, por emri i tij kurrë nuk vdes.*
2. *"nëse jep 'lëmoshë, pastron pasurinë, e nëse jep këshilla, e shton diturinë".*
3. *"Bëhu besnik e mos i zë besë çdokujtë".*
4. *"Nuk është trimëri të hidhërosh një mik, por trimëri është të zhdukësh një armik".*
5. *"Të luftosh për atdhe është lavdatë, kurse të vdesësh për të është dhuratë".*
6. *"Lumi që rrjedh kurrë nuk turbullohet, ushtari i mirë vdes e nuk dorëzohet".*
7. *"Të punosh do të thotë të fitosh, ndërsa të mos punosh do të thotë të sakrifikosh".*
8. *"Dijetari vlerësohet me mençurinë e tij, e të jesh i ditur duhet të kesh urtësinë".*
9. *Deti Adriatik di të flas edhe shqip".*

zgjedhi DRITON MORINA kl. III

MALISHEVË - Shkoroshnik

- Ishte nderë, krenari dhe mburrje që unë si nxënës i kësaj vatre të pashterrshme të diturisë, të shërbej si imam gjatë muajit të bekuar të Ramazanit në mesin e besimtarëve dhe vëllezërve të tokës shqiptare.

- Të përhapësh fjalën e Zotit ashtu siç udhëzon Ai është një obligim moral e shpirtëror që e kemi çdonjëri, e posaçërisht në muajin kur mëshira, begatia si dhe mirësia nga i madhi Zot arrin kulminacionin mëshirues.

- Pra, ishte dhe mbeti ende në shpirtin si dhe zemrën time të pastërt, kënaqësia e përjetimi i çasteve e mbremjeve islame që kaluam në fshatin me plot ndjenja fetare e kombëtare. Është për t'u mahnitur si dhe në ç'mënyrë dinin të ruanin dhe të vlerësonin pozitivisht çështjen rreth kulturës islame.

- Fshati Shkoroshnik është 3-4 km afër Malishevës, që është komunë në vete prej themelimit të saj. Është vështirë të flasësh për traditën si dhe kulturën etnike të këtij fshati bujar e fisnik, si dhe nuk ka mundësi që të përshkruhet në një revistë nxënësish. Patjetër duhet ta argumentojë tërë këtë kulturë dhe traditën islame - shqiptare, duke e ilustruar me një shembull të rrallë, e që nuk gjenden edhe në fshatra tjera. Pra ishte ajo që edhe islami thërret që të vëllazërohemi e të bashkohemi, duke mos qenë armiq mes veti. Do të thotë ende asnjë rast nuk ishte identifikuar që dikush nga fshatarët

t'i shtyjë arën dikujt, të mos flasin mes veti, të ketë ndonjë rrahje, keqtrajtim fizik, vrasje - shuarje jete etj. Pra tërësisht fshat ky me një vetëdije dhe kulturë të lakmueshme islame.

- Aktiviteti im, si nxënës dhe si imam, gjatë muajit të Ramazanit besoj se ishte në mënyrë mjaft lucid. Sepse tërë këtë mund dhe aktivitet e dëshmojnë dhe vërtetojnë në mënyrë më korrekte fshatarët - banorët e këtij fshati të cilët me pa durim i pritnin çastet e tubimit dhe takimit në kohën kur ne ishim duke komunikuar dhe ligjruar në mesin e tyre.

- Qëllimi im parësor ishte që në mesin ku prezentoja, rinia të jetë sa më shumë prezente, ashtu dhe ndodhi. Pra kontaktet më të rinjtë ishin të njëpasnjëshme, duke mos kursyer asgjë nga ana e jonë dhe e atyre rreth parimeve islame, duke i edukuar, mësuar rregulla e njohuri të ndryshme fetare. Si imam në këtë fshat kisha rreth 30 nxënës të cilët gjatë tërë muajit vijuan mësimbesimin tek ne. Pikërisht këta nxënës përfituan njohuri elementare praktike islame, ku edhe u vërtetua me shtimin e tyre çdo ditë e më shumë. Kështu kalonte koha, erdhi edhe fundi i ndarjes fizike mes nesh, ndërsa ideja, kultura dhe afërsia shpirtërore janë çdo herë mes nesh.

BAHRI GAZHI KL. IVb

A E DINI SE...

...Halifi el-Me'mun për punën e veprës së përkthyer e ka paguar me ari aq sa ka peshuar vepra.

...Ibn Nefis disa shekuj para Herit ka sqaruar qarkullimin e vogël të gjakut, ndërsa Ibni el-Hejsemi natyrën e dritës, shpejtësinë dhe ligjin e thyrjes së saj shumë më herët se shkencëtarët evropian.

...shkencëtarët arabo-islam kanë matur gjatësinë e meridianit të Tokës, kanë regjistruar baras ditën pranverore dhe vjeshtore, kanë caktuar dimensionet e planeteve dhe largësinë ndërmjet tyre para Galileut, Keplerit dhe Kopernikut.

...el-Bejruni në mënyrë shumë precize ka caktuar peshën specifike të 18 - metaleve deri te decimalja e katërt, e cila nuk ndryshon nga llogaritjet më të reja në kohën në të cilën janë zbuluar instrumentet më të përsosura.

...Ibni Miskivejh, Ibni Halduni dhe Ihvan-es Safa kanë folur disa qindra vjet, para Darvinit dhe Lamarkit, për evolucionin dhe zhvillimin e jetës si dhe për ndikimin e rrethinës në qeniet e gjalla.

...arabët të parët kanë përdorur fjalën algjebra me kuptim të cilin e ka edhe sot.

...Abdurrahman es-Sufi ka shkruar vepër të madhe të ilustruar për yjet e palëvizshëm në të cilin gjenden mbi 1420 yje dhe planete të ilustruar në formë të njerëzve dhe kafshëve, emrat e të cilëve edhe sot e kësaj dite janë në përdorim (Arusha e madhe, Arusha e vogël, Akrepi, Virgjresha etj.).

... në vitin 976 Muhammed ibni AHMEDI shtoi zeron numrave të njohur, me të cilën në shkencën e matematikës bëri revolucion.

...filozofi i njohur islam El-Farabi ishte njeri i shkollimit universal. Veprat e tij rreth 100 përfshijnë krejt spektrin e mundshëm të diciplinave shkencore dhe filozofike të cilat ishin të njohura në kohën e tij. Thuhet se përveç gjuhës arabe, turke, persiane, greke i dinte edhe 70 gjuhë tjera. Ishte poliglot i vërtetë.

ERMIR GEGA KL. IVa